



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof.As.Zhuljeta DAJA KADILLI
Prof.As.Florenca STAFI (HALILI)**

Mars / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr. 214 datë. 08.05.2023
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021 - 2022 7 PAE / 24 PAK; 2022 - 2023 7 PAE / 23 PAK; 2023 - 2024 7 PAE / 19 PAK;
18	Numri i studentëve:	2021 - 2022 65 studentë; 2022 - 2023 23 studentë; 2023 - 2024 12 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

Lidues

[Signature]

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës është një Institucion publik i arsimit të lartë, më i vjetri dhe më i madhi në vendin tonë dhe i krijuar në vitin 1957. Institucioni është ri akredituar me vendim nr.04 datë 27.01.2023, të Bordit të Akreditimit me kohëzgjatje 6 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri me 26.01.2029. Universiteti i Tiranës përbëhet nga 6 Fakultete dhe 2 Institute. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë përbëhet nga 6 departamente:

1. **Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore;**
2. Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit;
3. Departamenti i Gjeografisë;
4. Departamenti i Gjuhësisë;
5. Departamenti i Historisë;
6. Departamenti i Letërsisë;

Programi i studimit Bachelor në “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore” përfshihet në ciklin e parë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, Fakulteti Histori Filologji, Universiteti i Tiranës, dhe është lincësuar me Urdhër MAS Nr. 214 datë 08.05.2023. Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemit European të Transferimit të Krediteve në 180 kredite ECTS, ku në përfundim të tij përfitohet Diplomë Universitare Bachelor në “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore”.

Programi i Studimit ishte kërkesë dhe domosdoshmëri për kohën. Me zhvillimin dhe prioritetet që po i jepen, sidomos, zhvillimit të turizmit, bëhej e domosdoshme përgatitja e specialistëve të fushës, të cilët kishin munguar apo përgatitur me njohuri fare të pakta në programin e Historisë. Hapja e programit gjithashtu është e rëndësishme në studimet Albanologjike, për vlerësimin e identitetit dhe kulturës së popullit shqiptar. DATK është njësi bazë që ka përgjegjësinë për mbarrëvajtjen e programit dhe përgatitjen cilësore të studentëve. Në këtë aspekt, departamenti në bashkëpunim me institucione të tjera brenda e jashtë vendit, përpaket të realizojë sa më mirë misionin për të cilin u krijua programi. Ky program synon përgatitjen e specialistëve me aftësi akademike dhe në zotërimin e kompetencave në fushën e arkeologjisë, të trashëgimisë kulturore, restauratorëve, punonjësve të muzeve, specialistë të guidave turistike etj. Për të realizuar objektivat dhe synimet, DATK në vazhdimësi ofron mundësi për kualifikimin e personelit akademik, përmirësimin e infrastruktures dhe bashkëpunimin me institucione brenda e jashtë vendit që ndihmojnë në rritjen e cilësisë dhe aftësimin praktik të studentëve. Në përfundim të programit të parë të studimit lëshohet diploma “Bachelor”, në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është një dokument i hartuar nga një grup i caktuar për vlerësimin në tërësi të cilësisë, në institucionin e Arsimit të Lartë. Ky raport është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të parë për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor, ofruar nga Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturorë, Fakulteti Histori Filologji, Universiteti i Tiranës. Akreditimi është procesi i cili certifikon cilësinë e një Institucioni të Arsimit të Lartë (IAL) si dhe të programeve të tij të studimit. Metodologjia e punës për vlerësimin e jashtëm të DATK, bazohet në studimin e raportit (RVB) të paraqitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të departamentit, si edhe vizita e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ) në Departament, për verifikimin e të gjitha gjetjeve në raportin e vlerësimit të brendshëm. Raporti i hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm përmbledh të gjithë procedurën e zhvilluar gjatë procesit të vlerësimit të standarteve dhe kriterëve për ciklin e parë Bachelor, në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor. Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit të miratuar nga ASCAL/BA. Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga **Prof. As. Zhuljeta Daja (Kadilli)** dhe **Prof. As. Florenca Stafa (Halili)**. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë proces verësimi është **Msc. Majlinda Demirneli**. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

1. Marrja e materialeve të vlerësimit të brendshëm, pasi Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL, veç Raportit të Vlerësimit të Brendshëm edhe ndonjë saktësim apo plotësime në dokumentacionin e dërguar;
2. Studimi i dokumentacionit të vlerësimit të brendshëm, nëpërmjet dosjes, ku përfshihet RVB si dhe dokumentacioni mbështetës i referuar. Ky dokumentacion është baza për njohjen dhe vlerësimin e Departamentit, mënyrën e funksionimit të tij;
3. Pasi u shqyrtua raporti i paraqitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, u përgatit dosja me pyetje, diskutime dhe problematika të ndryshme, mbi bazën e të cilave u hartua një raport i shkurtër që do të paraprinte vizitën në DATK. Në këtë fazë u përgatit edhe axhenda e vizitës, lista e pyetjeve, problemet për t'u diskutuar sipas takimeve respektive, me dekanin, përgjegjësin e departamentit, pedagogët, stafin mbështetës, studentët etj;
4. Vizita në DATK e zhvilluar në datat 3 dhe 4 Tetor 2024. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit;

Në përfundim është dorëzuar raporti përfundimtar nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i cili përmban gjithshka të realizuar në departamentin e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturorë.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.01.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 46/1 Prot, datë 28.01.2025. Universiteti i Tiranës njofton në ASCAL më datë 12.02.2025, nëpërmjet shkresës me nr. 480/1, Prot, datë 12.02.2025 “Përcillen komentet për draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bsc Arkeologji dhe trashëgimi kulturore”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. **Lidhur me komentin në standartin IV.1 kriteri 2,** GVJ shqyrtoi dhe vlerëson dokumentacionin e përcjelle nga IAL, ku u konstatua se në të dhënat tabelore të paraqitura kishte lapsuse. Bazuar në të dhënat e përditësuara GVJ përditësoi të dhënat në raportin final. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
2. **Lidhur me komentin në standartin V.4 kriteri 2,** GVJ shqyrtoi dhe pranon komentin e institucionit, duke reflektuar edhe ndryshimin e gjetjes në raport, mbi numrin e studentëve të regjistruar. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
3. **Lidhur me komentin në standartin III.4 kriteri 1,** GVJ shqyrtoi dhe pranon komentin e institucionit, duke theksuar që është lapsus, dhe reflektuar ndryshimin e gjetjes në raport. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

Leadus 

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësishë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i ofruar nga Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturorë jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por, përkundrazi plotëson një boshllëk të krijuar në vite për specialistë të fushës. Në shkresën nr.7476, datë 20.10.2010 shprehet nevoja e institucioneve për specialistë të fushës, në institucionet qendrore dhe vendore. Edhe ndryshimi nga Arkeologji në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë është plotësisht i justifikuar e me vend, pasi nevojat për të dy sektorët ishte domosdoshmëri. Gjithashtu është në përputhje me praktikën evropiane e botërore nga më të mirat në fushën e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturorë. Një ndryshim i tillë është në përputhje të plotë me ligjin për Arsimin e Lartë. Hapja e këtij programi është domosdoshmëri për vendin tonë, sidomos tani me rëndësinë që ka Arkeologjia dhe Trashëgimia Kulturorë, në kontekstin e zhvillimit të turizmit si prioritet dhe për rrjedhojë edhe të ekonomisë. Tashmë në këtë sektor do të ketë specialistë, të formuar pikërisht në këtë program. Këto të dhëna janë rezultat i studimit të dokumentacionit të ofruar nga DATK dhe vizita e GJV në departament dhe biseda me pedagogët e tij. <i>Evidenca I.1. Dosja e plotë e programit Bachelor A&TK;</i> <i>Evidenca I.2 Mendimi i Dekanit për programin Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë;</i> <i>Evidenca I.9, Studimi i fizibilitetit, Tiranë 2012,f.3;</i> <i>Evidenca I.10, Shkresë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës; Rinisë dhe Sporteve 20.10.2010, pdf;</i> <i>Evidenca I.11, Ligji i TK, Nr.8048, date 7.04.2003 dhe amenduar në ligjin 9882, datë 28.02.2008;</i> <i>Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, 80/2015, neni 1, pika b. Neni 30, pika 1,3;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Nga studimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizita e GJV në departament vlerëson se: Programi i studimit bachelor në Arkeologji dhe trashëgimi Kulturorë është në përputhje të plotë me profilin që ka departamenti. Nevojat që kanë sot

Leoodaq *Shaf*

institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	institucionet qëndrore dhe lokale për specialistë të fushës së trashëgimisë e bënin të domosdoshëm hapjen e këtij departamenti. Programi i studimit i ofruar nga FHF dhe DATK është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit. Misioni për përgatitjen e studentëve orientohet drejt dhënies së njohurive akademike, formimit të kompetencave tek studentët me qëllim që të shërbejnë sa më mirë në sektorët ku do punojnë. Gjithashtu ky program shërben edhe për aftësimin praktik të studentëve në fushat përkatëse. Kjo arrihet nëpërmjet praktikave të planifikuara në terren. Hapja e këtij programi është në përputhje me studimin e fizibilitetit. Ky program njëkohësisht ndikon në zhvillimin e shkencave albanologjike. Synimet e programit janë në përputhje me interesat kombëtare dhe edukimin e studentëve duke ruajtur e konsoliduar vlerat akademike. Veç kësaj, ky program i vjen në ndihmë përgatitjes së specialistëve të studimit, ruajtjes dhe evidentimit të trashëgimisë kulturore. Në fushën e studimeve Albanologjike është vlerë e shtuar për vetë specifikën e programit, pasi ndihmon në dhënien e argumenteve për identitetin kombëtar. Këta specialistë do të dinë të promovojnë trashëgiminë kulturore të vendit tonë kudo në botë. Dhe kjo është shumë e rëndësishme për Shqipërinë. <i>Evidenca I.9, Studimi i fizibilitetit për hapjen e programit të ATK, Tiranë 2012.pdf;</i> <i>Evidenca I.12, Statuti i UT, 2018, neni 4, 5;</i> <i>Evidenca I.13, Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023, f.4;</i> <i>Evidenca I.9 Studimi i fizibilitetit për hapjen e programit të ATK, Tiranë 2012, f.3. pdf;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Nga dokumentacioni i konsultuar, vizita e GVJ në departament dhe takimi me stafin, vërejmë se, ideja për krijimin e departamentit të Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, ka qenë në përputhje të plotë me vizionin e institucionit, me qëllim që të ishte më i plotë në përmbajtje, për përgatitjen e specialistëve si dhe zhvillimin e shkenës së Albanologjisë. Të gjitha funksionet dhe kompetencat e këtij departamenti rregullohen në bazë dhe zbatim të <i>nenit 14</i> të Statutit të UT, i cili i njeh të drejtën departamentve të formulojnë programet, përmbajtjen e lëndëve dhe prioritetet e kërkimit shkencor. Kryesorja është që, në këto programe vihet re një qasje ndërdisiplinore, zhvillimi i mendimit kritik dhe sigurisht krijon kushte bashkëpunimi. Nga verifikimi i dokumentacionit provohet që programi është i mbuluar me ekspertizë nga stafi akademik efektiv në DATK dhe stafi akademik me kontratë nga departamente të tjerë si pjesë e UT dhe jashtë tij. Stafi

Leodeq 

	akademik i këtij departamenti ishte mjaft i kualifikuar. <i>Evidenca I.12, Statuti i UT, 2018, neni 14, f.8-10, pdf;</i> <i>Evidenca I.14, Plani strategjik për zhvillimin e Departamentit të Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, FHF, 2022-2023, pdf;</i> <i>Evidenca I.15. Rregullore e UT, pdf;</i>																					
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Dokumentacioni dhe vizita e GVJ në departament, tregojnë se: Që në nisje të inisiativës për hapjen e programit të ATK, institucioni provoi se kishte përvojën, ekspertizën, kapacitetet e duhura si në fushën akademike për ofrimin e një program të tillë dhe në atë të kërkimit. Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, është një prej gjashtë departamenteve që ka FHF. Koha dhe kërkesat e vazhdueshme e bënë të domosdoshëm hapjen e një program të tillë studimi. Kërkesat e vazhdueshme për specialistë gjithashtu ishin një arsye më shumë. Veç kësaj edhe vetë dega e Historisë me lëndët e zhvilluara (ku zhvilloheshin disa lëndë të arkeologjisë) nuk mundësonte përgatitjen e ekspertëve për fushën e arkeologjisë apo të trashëgimisë kulturore. Në këtë kontekst hapja e departamentit të ATK ishte zgjidhja e duhur. Në vitin akademik 2023-2024 Fakulteti i Histori Filologjisë ka në përbërjen e tij 187 staf akademik gjithsej, nga ku 93 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 94 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin si më poshtë: <table><tr><th colspan="3">Fakulteti Histori Filologji</th></tr><tr><th>Kualifikimi</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>23</td><td>21</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>27</td><td>9</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>36</td><td>30</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>7</td><td>34</td></tr><tr><td>Total</td><td>93</td><td>94</td></tr></table> Ndërsa Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, i cili është përgjegjës për programin e studimit, në vitin akademik 2023-2024 ka në përbërjen e tij 26 staf akademik gjithsej, nga ku 7 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 19 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin si më poshtë:	Fakulteti Histori Filologji			Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	23	21	Prof. Asoc.	27	9	Dr./PhD	36	30	Msc.	7	34	Total	93	94
Fakulteti Histori Filologji																						
Kualifikimi	PAE	PAK																				
Prof. Dr.	23	21																				
Prof. Asoc.	27	9																				
Dr./PhD	36	30																				
Msc.	7	34																				
Total	93	94																				

	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore		
	Kualifikimi	PAE	PAK
	Prof. Dr.	2	1
	Prof. Asoc.	2	2
	Dr./PhD	3	8
	Msc.	0	8
	Total	7	19
<i>Evidenca I.29 Departamentet e Fakultetit Histori Filologjisë;</i> <i>Evidenca I.12 Statuti i UT, Kreu 2, Neni 14, pika 4;</i> <i>Evidenca I.3 Aneks Tabela Përmbledhëse, Tabela Nr.4;</i> <i>Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Arkeologji e Trashëgimi kulturore;</i> <i>Evidenca I.30. CV e stafit Akademik të programit të ATK, pdf;</i>			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Nga studimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vizita e GVJ në departament vërtetojmë se fusha e programit të studimit është në përputhje me fushën kërkimore të njësisë bazë, e cila është përgjegjëse për programin e studimit. Duke parë programet e përgjithshme dhe specifike shikojmë se janë në përputhje me direktivat e udhëzimet kombëtare e evropiane. Veç kësaj edhe ndryshimi i përmbajtjes së programit nga Arkeologji në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore ishte kërkesë e domosdoshme e kohës. Me këtë program u plotësua një boshllëk në përgatitjen e specialistëve për gjurmimin, evidentimin, restaurimin, konservimin, reklamimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike, por edhe me kërkimin shkencor të personelit akademik. Edhe klasifikimi i programeve është bërë sipas sugjerimeve kombëtare dhe evropiane. Kualifikimi dhe profilizimi i personelit akademik është garanci për një klasifikim dhe kodifikim të programeve lëndore në përputhje me ligjin për Arsimin e Lartë. <i>Evidenca I.30 CV e stafit Akademik të programit të ATK;</i> <i>Evidenca I.31 Parametrat e standartit të Diplomës referuar sistemit të Bolonjës, pdf;</i> <i>Evidenca I.16 Për elemente e programeve të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë;</i> <i>Evidenca I.18 Cikli i parë i Studimeve Bachelor në Universitetin e Tiranës ofron një kurrikulë të perceptuar sipas standarteve të Krtës së Bolonjës në pdf;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite në DATK, pdf;</i>		

	<i>Evidenca Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë 80/2015, neni 86;</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore, është plotësisht në përputhje me interesat kombëtare dhe nevojës për përgatitjen e specialistëve në fushat përkatëse. Gjithashtu është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe përvojat ndërkombëtare.</i> <i>Departmenti që ofron programin ka përvojën, kapacitetet, infrastrukturën dhe të gjitha burimet logjistike të nevojshme, laboratorë, bibliotekë etj. Gjithashtu është një ekip pedagogësh mjaft i kualifikuar dhe me përvojën e duhur si në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. Të gjitha këto ndihmojnë për cilësinë sa më të mirë të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizita si grup i vlerësimit të jashtëm në DATK, pamë se ky departament ka një mbikëqyrje të vazhdueshme dhe sistematike mbi mbarëvajtjen e programit. Në këtë aspekt është përparë për të siguruar marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit, nëpërmjet ndarjes së detyrave, që nga dekani, përgjegjësi i departamentit dhe pedagogët. E rëndësishme të theksojmë se nxitja e zhvillimit të qendrueshëm të DATK është kryer nëpërmjet vendosjes së bashkëpunimit me organizmat brenda institucionit, duke marrë secili përgjegjësi të duhura. Ky bashkëpunim rregullohet dhe zbatohet sipas rregullave të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe rregulloreve të Institucionit. Departamenti i ATK, si njësi bazë duke qenë në marrëdhënie bashkëpunimi institucional dhe është i vëmendshëm ndaj sugjerimeve që i bëhen nga senati për ndryshime programi, kriteret e pranimit, praktikat mësimore, rekrutimet e personelit me kohë të plotë apo të pjesshme etj. Veç këtyre marrëdhëniet brenda institucionit, me njësinë kryesore, Dekanin dhe Rektorin (Senatin Akademik) ndihmon në ndihmat financiare për bursat e studimit, realizimin e projekteve kërkimore, shkollat verore. Edhe bashkëpunimi me departamentet e tjera ndihmon në kryerjen e projekteve të

Leoneq *[Signature]*

	përbashkëta, lëndëve të integruara në programin e Studimit, apo edhe veprimtarive të tjera duke promovuar në këtë mënyrë bashkëpunimin. Marrëdhënie bashkëpunuese është edhe IT, specialistë të tij ndjekin procesin mësimor, nevojat e pedagogëve dhe programit të studimit. Bashkëpunimi ka mundësuar që nëpërmjet programit CleanScore të korrigjohen testet. Ky project ndiqet në vazhdimësi nga zyra e posaçme në FHF. Një tjetër fushë bashkëpunimi është me zyrën e këshillimit të karrierës. Në ditët e veçanta kjo zyrë i njeh me gjithashka që ofron departamenti dhe pse duhet zgjedhur ky program studimi. Në përfundim, bashkëveprimi brenda institucionit krijon lidhje dhe hapësira të shumta që ndihmojnë në procesin e mësimdhënies dhe rritjen e cilësisë së programit të ofruar nga DATK. <i>Statuti i UT, neni 12;</i> <i>Evidenca I.32 Kodi i Etikës UT, pdf;</i> <i>Evidenca I.12 Statuti UT, neni 31, pika dh 47;</i> <i>Evidenca I.33 Urdhër i brendshëm i Dekanit të FHF, nr.530 dt 28.04.2022;</i> <i>Evidenca I.34 Lista e bursave e miratuar, pdf;</i> <i>Evidenca I.35 Vendimi nr.29 i Senatit Akademik i UT, dt. 22.07.2021. pdf;</i> <i>Evidenca I.36 Shkresë e Dekanit të FHF, nr.713, 21.06.2021, thirrje për Projekte Kërkimore Shkencore, pdf;</i> <i>Evidenca I.37 Biblioteka e Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca I.38 Projekti Clean Score, pdf;</i> <i>Evidenca I.40 Raporti i implementimit të projektit Clean Score, AADF, pdf;</i> <i>Evidenca I.42 Projekti Clean Score në DATK, pdf;</i> <i>Evidenca I.41 Politikat që ndjek DATK për promovimin e programeve të studimit dhe Udhërrëfyesi i programeve të studimit në FHF, 2017. Pdf;</i> <i>Evidenca I.43 Organika e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë.pdf;</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Dokumentacioni i ofruar nga RVB dhe takimi i GVJ me anëtarët e stafit vumë re se, stafi ishte plotësisht i qartë për rrugët dhe mënyrat e realizimit të objektivave mësimore, të cilat luajnë rol në formimin e studentëve. Madje objektivi kryesor ishte bashkëpunimi me institucione homologe, brenda e jashtë institucionit që të ndikonin në rritjen e cilësisë së programit të studimit. Për këtë arsye ata kishin vendosur lidhje me një numër të konsiderueshëm institucioneesh brenda e jashtë vendit. Mjafton të përmendim bashkëpunimin me projektet kërkimore shkencore, projekte të zhvillimit public, institucione qendrore dhe vendore të TK apo organizata joqeveritare, inisiativa private etj. Këto marrëveshje bashkëpunimi synojnë

Leondrej 

	që studentët të kenë një qasje të re në institucionet e TK dhe njëkohësisht të familjarizohen me punën në to. Këto marrëveshje janë bërë në nivel Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti. Marrëveshjet flasin për një punë mjaft serioze dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e formimit të studentëve dhe sjellin pranë programit të studimit sfidat dhe përballjen me problematikën në sektorin e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore. Këto marrëveshje janë tepër të studiuara në aspektin e përmbajtjes dhe qëllimit të tyre. Ato përmbajnë që nga rregulloret deri tek mënyra e funksionimit si dhe personat përgjegjës. Këto marrëdhënie do iu krijonin studentëve të përfitonin në fushat special të ekspertizave, por edhe krijimin e një netëorke për depërtimin në mundësitë që iu krijohen në tregun e punës pas diplomimit. Që në fillimet e programit të studimit, studentët janë bërë pjesë e projekteve të ndryshme, në bashkëpunim me universitetin Costen në Los Anxheles apo praktikantët e gërmimit në Tren të Korçës. Projekt shumë i rëndësishëm është ai TAP. Sipas RVB ka mjaft shembuj që provojnë projektë bashkëpunuese në mjaft sektorë të Arkeologjisë apo Trashëgimisë Kulturore. Gjithashtu janë bërë pjesë e projekteve Erasmus, të cilët kanë ndikuar për rritjen e cilësisë si dhe përfshirjen e tyre në një përvojë ndryshe. <i>Evidenca Culture Heritage Without Borders; Evidenca I.44 Memorandum mirëkuptimi AADF-CHwB-DATK-MK, datë 4 .10.2015; Evidenca I.44 Memorandum mirëkuptimi AADF-CHwB-DATK-MK, datë 4 .10.2015, pikat 34, 35; Evidenca I.45 Memorandum mirëkuptimi FHF,UT-CHwB- datë 21.12.2021; Evidenca I.46 Vërtetime bashkëpunimi CHwB-DATK për secilin projekt;</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë njohjes me materialin dhe nga vizita në departament konstatoi përpjekje shumë pozitive për realizimin e programit të studimit, sidomos nëpërmjet vendosjes së bashkëpunimit me institucione kërkimore dhe kompani të fushës për kryerjen e praktikave mësimore. Këtij komponenti i kanë dhënë rëndësinë e duhur duke e parë si element mjaft të domosdoshëm në formimin dhe zotërimin e kompetencave të studentëve. Gjithashtu nëpërmjet këtij bashkëpunimi kanë vlerësuar zbatimin e njohurive akademike të studentëve në praktikë. Studentët janë ndjekur gjatë procesit të praktikave profesionale apo stazhit nga ekipe pedagogësh specialistë të fushave.

Leaderez 

	<i>Evidenca 1.59 Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale të mëtjeshmë për studentët e diplomuar, në pdf;</i> <i>Evidenca 1.60 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, pdf;</i> <i>Evidenca 1.61 Analiza e DATK mbi arritjen e objektivave të studimit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional, pdf;</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita e GJVJ në departament u konstatua se departamenti ka bërë një punë serioze në ndjekjen dhe raportimin e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione brenda e jashtë vendit. Këto marrëveshje janë ndjekur sistematikisht dhe rezultatet e tyre janë raportuar në departament. Analizat e veprimtarive kanë qenë mjaft të hollësishme dhe në funksion të rritjes së cilësisë së përvehtësimit të programit. Për çdo problematikë të dalë janë bërë përmirësimet e duhura për të ardhmen. Një gjë e tillë ka ndikuar në rritjen e cilësisë së të nxënit dhe mësimdhënies. Ndjekja dhe raportimi i vazhdueshëm ka bërë që të vlerësojë në kohë marrëveshjet dhe bashkëpunimin. Në këtë aspekt ishte bërë një punë serioze. <i>Evidenca 1.60 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, pdf;</i> <i>Evidenca 1.61 Analiza e DATK mbi arritjen e objektivave të studimit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional, pdf;</i>			
Konkluzione	Në përfundim të vlerësimit të këtij standarti GJVJ arrin në përfundimin se, DATK ka bërë një punë shumë të mirë për përbushjen e standartit, në mënyrë cilësore. Thelbi i këtij standarti ka të bëjë me vendosjen e bashkëpunimit me institucione, kompani biznesi, palë të treta, brenda e jashtë vendit. Ka një numër të madh kontrata bashkëpunimi me institucione të ndryshme, të cilat nuk janë thjesht në letër, por janë të materializuara konkretisht, dhe për këtë ka raporte analitike periodike. Këto marrëveshje kanë pasur impakt pozitiv në rritjen e cilësisë së njohurive të studentëve dhe aftësimit të tyre me kompetenca.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
--	---------------	----------------------	---------------------	----------------------

				X
--	--	--	--	---

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga verifikimi i kryer nga GVJ në vizitën e bërë në departament shikojmë se, programi i studimit është në përputhje me aktet ligjore kombëtare në fuqi, si dhe me ligjin e Arsimit të Lartë. Planet mësimore janë qartësisht të organizuara në lëndë e module. Brenda tyre, në mënyrë të saktë, janë vlerësuar lëndët sipas rëndësisë në formimin e studentëve si dhe janë llogaritur orët mësimore të studimit për secilin program si dhe kreditet në përputhje me Sistemin Evropian të Krediteve (ECTS). Kjo mundëson lehtësisht transferimet e studimeve brenda e jashtë vendit, të shkojnë për kualifikime apo për periudha të caktuara për studime. Programi është organizuar në përputhje me rregulloren e UT dhe rregulloren e DATK. Ky program është organizuar në 3 vite 6 semestra me 180 kredite. Çdo vit akademik studenti merr 60 kredite dhe në përfundim të studimeve ka marrë 180 kredite. <i>Evidenca I.16, Vendimi Nr.41 datë 24.01.2018-Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pdf;</i> <i>Evidenca II.1 Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve (ECTS);</i> <i>Evidenca I.15 Rregullore e UT, pdf. Kreu I, neni 31;</i> <i>Evidenca I.17 Rregullore e DATK për organizimin e programit të ciklit të parë të studimeve bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor, pdf;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe	Duke analizuar përmbajtjen e programit të studimit, vëmë re se, në filozofinë e tij ka qenë formimi i studentëve në pikëpamje akademike dhe si dhe aftësimin për zotërimin e kompetencave profesionale dhe akademike gjë që do i ndihmojë ata në zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave. Kurrikula e re ka ndryshime rrënjësore me kurrikulat e mëparshme, pasi ajo heq dorë nga të mësuarit mekanik të dijeve në një fokus të ngushtë të një disipline. Duke pasur parasysh kërkesat që shtrohen sot në një numër të madh specialitetesh në fushën e

Leoneq *Ref*

parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore si dhe kërkesat e tregut të punës, DATK ka për qëllim të plotësojë boshllëkun e krijuar për specialistë në këto fusha. Në mënyrë të veçantë në zgjidhjen e problemeve të vështira që ju paraqiten gjatë punës në një fushë të specializuar ose profesionale. Veç kësaj programi ka në qendër të menduarin kritik si një strategji të të mësuarit nëpërmjet shkrimit dhe leximit. Të mësuarit kritik si strategji i pajis studentët me nivele të ndryshme të të mësuarit, nga njohja tek procesi i vlerësimit dhe zbatimit. DATK ka si objektiv që në këtë program të pregatisë studentë me dije dhe njohuri konkrete për t'i ushtruar në terrene, institucione, laboratorë etj. I gjithë programi me lëndët qoftë ato lëndë bazë, karakterizuese, integruese apo plotësuese në fund ato kanë si objektiv përgatitjen e studentëve dhe aftësimin për të punuar me ekspertizë në fushën e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore. si: specialist në përdorimin e metodave bashkëkohore për studimet arkeologjike, konservues të TK, muzeologë, specialist të ATK në institucionet qendrore dhe lokale, specialistë në mbledhjen e të dhënave me metoda si GIS, TST, Dron, formulimin e guidave turistike etj. <i>Evidenca 1.1 Dosja e plotë e programit Bachelor në A&TK, pdf;</i> <i>Evidenca 1.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite compressed pdf;</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Gjatë njohjes me programet e lëndëve të programit të studimit ATK, vërejmë se ato janë mjaft të studiuar dhe përmbushin objektivat për formimin e studentëve me njohuri të qëndrueshme akademike dhe kompetenca. Në radhë të parë hartuesit e programeve kanë pasur parasysh përmbajtjen dhe filozofinë e Programit të Studimit, synimet dhe qëllimet e tij. Nisur nga kërkesat e institucioneve qendrore dhe lokale për specialistë të fushës ata e kanë orientuar përmbajtjen e programit në këtë drejtim. Lëndët janë grupuar sipas përmbajtjes apo afri së tyre. Lëndët janë ndarë në grupe sipas rëndësisë, lëndë të formimit bazë ku janë grupi i lëndëve bazë të formimit të përgjithshëm, lëndët karakterizuese, integruese dhe plotësuese. Kuptohet që lëndët karakterizuese janë më të rëndësishme në formimin akademik dhe kanë më shumë orë mësimore dhe kredite. Por, jo më pak të rëndësishme janë lëndët e formimit bazë, integruese, apo me zgjedhje. Në përputhje me këtë ndarje është bërë edhe përcaktimi i krediteve sipas metodologjisë së përcaktuar. Një punë shumë e studiuar është bërë edhe për ndarjen e lëndëve me zgjedhje në grupe, sipas rëndësisë dhe përmbajtjes së tyre.

Leary *Sh*

	Brenda grupit ka ngjashmëri dhe afri në kontekstin teorik dhe praktik. Numri i orëve është më i vogël dhe kreditet më pak. E rëndësishme është që departamenti iu përgjigjet të gjitha kërkesave dhe interesave të studentëve. Dokumenti i vënë në dispozicion është tepër i qartë dhe i plotë, po kështu edhe diskutimi në departament gjatë vizitës me GVJ. <i>Evidenca I.16 Vendimi Nr.41 datë 24.01.2018-Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pdf;</i> <i>Evidenca I. 19 Planet mësimore të miratuara me vendim senati, pdf;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite_compressed pdf;</i> <i>Evidenca II.7 Udhëzimi i MAS numër 10 datë 30.03.2020, për përcaktimin e elementeve përbërës, Formën e Diplomës ose Çertifikatën e lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pdf;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Grupi i punës që ka përgatitur dokumentacionin për hapjen e degës së Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, ka bërë një punë të lavdërueshme në përgatitjen e dokumentacionit. Brenda përmbytjes kanë listuar lëndët të cilat e formonin më mirë studentin në pikëpamje akademike, por njëkohësisht kanë menduar edhe për zotërimin e shprehive praktike dhe kompetencave për punën në institucione dhe terren. Madje për t'i dhënë rëndësinë e duhur dhe për të ndikuar drejtpërsëdrejti kanë programuar edhe praktikën profesionale me një numër të caktuar kreditesh. Praktika Profesionale bën pjesë në grupin e lëndëve plotësuese dhe ka 10-15% të numrit të krediteve. Kjo praktikë do të shërbejë që studentët të aplikojnë konkretisht në terren apo institucione të gjitha njohuritë e marra në auditor. Në fund të ciklit, por jo më pak të rëndësishme janë detyrimet përmbyllëse, mbrojtja e diplomës, provimi përfundimtar, edhe këto me ngarkesë të caktuar dhe vlerësuar me numër kreditesh. Kjo është mënyra e funksionimit dhe përmbylljes së sistemit Bachelor. <i>Evidenca I.16 Vendimi Nr.41 datë 24.01.2018- Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pdf;</i> <i>Evidenca I.31 Parametrat e standartit të Diplomës referuar sistemit të Bolonjës, pdf;</i> <i>Evidencë I.33, Urdhër i brendshëm i Dekanit të FHF, Nr.530, datë 28.04.2022, mbi zhvillimin e ekspeditave mësimore, pdf;</i> <i>Evidenca II.1 Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve (ECTS), pdf;</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve,	Gjetjet gjatë vizitës në departament nga GVJ dhe dokumentacionit të ofruar, provuan se ishin në përputhje të

pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	plotë. Fakulteti i Histori Filologjisë si pjesë e UT, nuk ka status të veçantë, e për rrjedhojë nuk ka kriteret të veçanta. Në këtë kontekst DATK pranimet e studentëve i bën në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, kriteret e përcaktuara nga ministria përkatëse dhe rregulloren e UT. <i>Evidencë II.8 Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 436, datë 03.06.2020, pdf;</i> <i>Evidencë II .9 Propozimi i kuotave nga DATK për vitin akademik 2022-2023, pdf;</i> <i>Evidencë II.10 Kriteret e pranimet në ciklin e parë të studimeve Bachelor dhe një program të integruar të ciklit të Dytë të Universitetit të Tiranës, pdf;</i> <i>Evidencë II.11 Miratimi i kuotave të prnimit në programet e studimit të nivelit të parë Bachelor në UT për vitin akademik 2021-2022, pdf;</i> <i>Evidencë II.12 Miratimi i kuotave të prnimit në programet e studimit të nivelit të parë Bachelor në UT për vitin akademik 2022-2023, pdf;</i> <i>Evidencë V.1 Udhëzim Nr.10, datë 15.05.2019, për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në nivelin e parë të studimeve, pdf;</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga biseda në DATK me anëtarët e departamentit, mësuam se në momentin e aplikimit për hapjen e Programit të Studimit në Arkeologji e Trashëgimi Kulturor, nuk kishte të tillë program në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në përmbajtje apo emërtesë. Në rast se do të kishte, patjetër që do të zbatonin ligjin për Arsimin e Lartë që në përmbajtje të ishte më së paku 70% i ngjajshëm apo i përafërt. <i>Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, Neni nr. 86, pika 2;</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit është shoqëruar me kodifikimin përkatës, të përcaktuar sipas rregullores së MAS, për Kodifikimin e Programeve të Studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë dhe Ligjin e Arsimit të Lartë. Ky kodifikim është bërë sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Specifikimet dhe përmbajtja për kodifikimin e programeve të studimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pas kodifikimit të programit është kryer kodifikimi i lëndëve të programit. Të gjitha këto janë pjesë e procesit të vendimit për hapjen e Programit të Studimit. <i>Evidenca I.1 Dosja e plotë e programit në Arkeologji e Trashëgimi Kulturor;</i> <i>Evidenca: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015, neni nr.86;</i> <i>VKM Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit</i>

Leart 

	të ofruara institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë; <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite compressed pdf;</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Sipas të gjithë dokumentacionit të konsultuar si GVJ dhe biseda me anëtarët e DATK, ky departament nuk ka programe të përbashkëta studimi me programe të njehta apo të ngjashme në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri apo vë vende të tjera jashtë saj. Që në hapjen e tij, por edhe në planin Strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm të departamentit 2022-2032 e kanë si objektiv vendosjen e bashkëpunimit me institucione të tjera brënda e jashtë vendit, si UNESCO, ICOMOS, ICCROM, ICOM etj. Gjithashtu do të jetë e hapur për të vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet shqiptare qendrore dhe vendore shqiptare për të ofruan ndihmë të ndërsjelltë, veçanërisht në praktikën e studentëve në nivele të ndryshme. Këto institucione janë që nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Parqeve Arkeologjike, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Muzetë vendore, administratën vendore, Instituti i Monumenteve të Kulturës etj. Sigurisht, në objektivat e ardhme të DATK do të jetë edhe hapja e programeve të përbashkëta të studimit me Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri, por, pse jo dhe ato të vendeve të huaja. Ky bashkëpunim do të jetë në përputhje me ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë. <i>Evidenca I.14 Plani strategjik i zhvillimit të Departamentit të Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, FHF, UT, 2022-2032, pdf;</i> <i>Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë 80/2015, Neni nr.80;</i> <i>Evidenca I.17, Rregullore e DATK për organizimin e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Arkeologji e Trashëgimi Kulturore, Nni 3, pdf.</i>
Konkluzione	Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe gjetjeve në DATK, GVJ është i mendimit se, programi i Studimit në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore është në përputhje me ligjet kombëtare në fuqi dhe rregulloret e dala nga MAS. Elementët e programit janë në një linjë me Sistemin Evropian të grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve, gjë që lejon mundësinë e transferimit të studentëve brenda e jashtë vendit. Kanë bërë një përcaktim të qartë të lëndëve sipas rëndësisë së formimit të studentëve, sipas programit të programeve. Edhe pranimi i studentëve apo financimi është sipas legjislacionit dhe rregullores së UT dhe FHF.

Leoneq 

	Kodifikimi i Programit të Studimit është bërë rogram ligjit, dhe kriteve të përcaktuara nga MAS. Në këtë mënyrë është kryer edhe kodifikimi i lëndëve. Programi i Studimit është organizuar në përputhje me të gjitha parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve															
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Universiteti i Tiranës, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.04, datë 27.01.2023 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 6 vite, për periudhën nga 27/01/2023 deri në 26/01/2029. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë përbëhet nga 6 departamente: 1. Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore; 2. Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit; 3. Departamenti i Gjeografisë; 4. Departamenti i Gjuhësisë; 5. Departamenti i Historisë; 6. Departamenti i Letërsisë; Duke përmbushur kështu edhe kriteret ligjore për qëndrueshmërinë e njësisë kryesore. Në vitin akademik 2023-2024 Fakulteti i Histori Filologjisë ka në përbërjen e tij 187 staf akademik gjithsej, nga ku 93 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 94 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin si më poshtë: <table><tr><th colspan="3">Fakulteti Histori Filologji</th></tr><tr><th>Kualifikimi</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>23</td><td>21</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>27</td><td>9</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>36</td><td>30</td></tr></table>	Fakulteti Histori Filologji			Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	23	21	Prof. Asoc.	27	9	Dr./PhD	36	30
Fakulteti Histori Filologji																
Kualifikimi	PAE	PAK														
Prof. Dr.	23	21														
Prof. Asoc.	27	9														
Dr./PhD	36	30														

Leone

	Msc.	7	34			
	Total	93	94			
Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:						
Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	3	2	2	2	1
Prof. Asoc.	2	2	2	3	2	2
Dr./PhD.	3	10	3	10	3	8
Msc.	0	9	0	8	0	8
Totali	7	24	7	23	7	19
<i>Evidenca II.2 Manual, Procedurat dhe Afatet për vlerësimin e Cilësisë në Kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, ASCAL 2017, pdf;</i> <i>Evidencë I.5 Shkresa e Rektorit 1445, nr. Prot. Datë 2.06.2021, Mbi Akreditimin e Programeve në UT, pdf;</i> <i>Evidencë I.6 Shkresa e Dekanit 632/1 Prot. Datë 16.06.2021, Kthim përgjigje mbi aplikimin për akreditim të programeve të Studimit në FHF dhe propozimi i DATK. Pdf;</i> <i>Evidenca I.8 Shkresa e Dekanit të FHF nr.830/6, datë 10.11.2021, për ngritjen e NJSBC të FHF, pdf;</i> <i>Evidenca I.3. Aneks, Tabelat Përmbledhëse;</i>						
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Dokumentacioni dhe verifikimi gjatë vizitës i GVJ në departament, pa se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit kishte përmbushur me përgjegjësi detyrimet e përcaktuara nga ligji në fuqi. Realizimi i programit të studimit varet nga shumë elementë të cilët mund të realizohen vetëm me një personel ndihmës akademik të angazhuar qoftë për mbarëvajtjen e procesit mësimor apo praktikave mësimore, labororet etj. Në këtë departament pamë nga afër dhe vlerësuam veprimtarinë e personelit ndihmës akademik. Ky personel kryen të gjithë punën përgatitore që nga asistimi për regjistrim, matrikullim deri tek njoftimi për datat e provimeve, apo dhe përgatitjen e dokumentacionit për transferim studimesh etj. Kjo ishte një punë sistematike e kryer me korrektesë dhe pa të nuk mund të quhej i realizuar programi. Personeli bënte lidhjen midis departamentit dhe problemeve burokratike. Edhe					

Leodan

[Signature]

	biblioteka ishte një tjetër element që funksiononte në ndihmë të procesit mësimor për realizimin cilësor të programit të studimit. Pedagogët dhe studentët kishin akses në bazë të një rregulloreje mbi të cilën funksiononte. Ky personel u tregua i gatshëm të bashkëpunonte dhe referonte të gjitha detyrat që kryente. <i>Evidenca II.5 Rregullore e Sekretarisë Mësimore në FHF, pdf;</i> <i>Evidenca II.6 Rregullore e Bibliotekës së FHF, pdf;</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia kryesore për ecurinë sa më të mirë të programit të studimit ka caktuar kordinatorin e programit. Ai kryen detyrën në vlerësimin formal të procesit, duke e ndjekur atë. Kordinatori ndjek të gjitha problemet e dala gjatë procesit mësimor, problemet e studentëve dhe ve në dijeni titullarin e njësisë bazë. Kjo njësi është përgjegjësjë kryesore e ecurisë së programit. Gjithashtu ndjek me rigorozitet praktikat profesionale aty ku bëhen duke parë përmbushjen e objektivave, por përcjell edhe problematikat e dala gjatë procesit me qëllim përmirësimin e tyre. Kjo detyrë kryhet në bazë të rregullores dhe Ligjit të Arsimit të Lartë. E gjithë kjo procedurë ishte e përshkruar në raportin e vlerësimit të brendshëm, por dhe doli nga biseda e GVJ me anëtarët e departamentit të ATK. <i>Evidenca I.13 Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2032, pdf;</i> <i>Evidenca II.3 Rikonfirmimi i koordinatorit të programit të studimit Bachelor në DATK, pdf;</i> <i>Evidenca II. 4. Rregullore e NJSBC neni 7;</i> <i>Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, neni 25 pika 3;</i>			
Konkluzione	<i>Fakulteti Histori Filologji në përgjithësi dhe Departamenti i Arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë.</i> <i>Që nga organizimi i strukturës Akademike, plotësimi me personel shumë të kualifikuar, caktimi i personelit akademik ndihmës, kordinatorit të programit, të cilët kryenin me përpikmëri detyrat e tyre.</i> <i>Çdo bashkëpunim funksiononte në bazë të legjislacionit dhe rregullores gjë që shpinte në përmbushjen e misionit dhe objektivave të departamentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Ledezi

[Signature]

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizita e GJVJ në departament konstatohet se programi, Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor është kryer brenda të gjithë ligjeve dhe rregullores së DATK. Të gjitha dokumentet e paraqitura dhe biseda në departament tregonin qartë lidhur me dokumentacionin e domosdoshëm për hapjen e programit të studimit. Nisur nga qëllimet dhe objektivat e hapjes së këtij programi është bërë një punë e studiuar mirë për lëndët që do të studioheshin, madje është bërë dhe një ndarje sipas VKM 41 në lëndë bazë, karakterizuese, interdisiplinare dhe plotësuese. Ndarja është bërë në përputhje me përmbajtjen e tyre dhe roli në formimin e studentëve. Nga ana tjetër DATK që në themelimin e tij ka zbatuar Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Programi zgjat 3 vite akademike me nga 60 kredite secili. VKM nr.41, pika 2 ka qenë në qendër të organizimit të programit. Dokumentat ishin mjaft të sakta dhe u konfirmuan nga takimi me dekanin dhe përgjegjësen e departamentit. Ata kishin pikësynime të qarta dhe formatin e programit të studimit tejet të studiuar. <i>Evidenca I.16 Vendim nr.41, datë 24.01.2018 Për elementët e Programit të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pdf;</i> <i>Evidenca I.15 Rregullore e UT, pjesa e III, Organizimi, Struktura, Elementët e Studimeve;</i> <i>Evidenca I.15 Rregullore e UT, pdf;</i> <i>Evidenca I.17 Rregullore e DATK për organizimin e programit të ciklit të parë të studimeve bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor, pdf;</i> <i>Evidenca I.19 Planet Mësimor të miratuara me vendim Senati. Pdf;</i> <i>Evidenca I.3 Aneks, Tabelat Përmbledhëse, pdf;</i> <i>Evidenca I. 20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite_compressed pdf;</i> <i>Evidenca I.16 Vendim nr.41, datë 24.01.2018 Për elementët e Programit të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, shtojca nr.1, tabela nr.1.pdf;</i> <i>Evidenca I.16 Vendim nr.41, datë 24.01.2018 Për elementët e Programit të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pika 2 a-g. Model Suplementi i Diplomës;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm	Edhe për këtë kriter të standartit të organizimit dhe administrimit të programit është vënë në dispozicion dokumentacioni i nevojshëm. Nga ky dokumentacion dhe vizita e GJVJ në departament vlerësojmë se brenda planit mësimor

Lloshaj



për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	përfshihet informacioni i nevojshëm i cili ndikon në përgatitjen dhe formimin e studentëve si specialist të ATK. Gjithashtu ky informacion është organizuar në lëndë të cilat bëhen në semestra të ndryshëm. Ndarja në semestra është bërë e studiuar, sipas rëndësisë së njohurive që jepen në secilën lëndë. Në bazë të njohurive dhe rëndësisë që ka në formimin e studentëve është bërë edhe përcaktimi i orëve të studimit në auditor e jashtë tij. Mbi këtë përlllogaritje janë përcaktuar edhe kreditet për secilën lëndë. Kryesorja në program është mësimi i zhvilluar në auditor i bazuar në leksione dhe seminare. Leksionet zhvillohen në mënyrë interaktive, ku edhe studentët janë pjesëmarrës. Zhvillohen me poëer point, por ka edhe raste të leksioneve nga personalitete të ftuar të shkencës. Tek seminarët në qendër është studenti, që me anë të strategjive të menduarit kritik bëjnë vlerësimin e procesit, diskutojnë dhe mbajnë qëndrimet e tyre. Ata fitojnë kompetencat e duhura akademike. Përsa i takon procesit të vlerësimit ai bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë seminareve, me detyra të cilat i përmbahen rregullave të shkrimit akademik si dhe kryesorja është provimi përfundimtar i secilës lëndë. Vlerësimi përfundimtar i njohurive të studentëve është diploma, e cila kërkon afërsisht 200 ore punë individuale. Në fund i nënshtrohen paraqitjes përpara komisionit të ngritur nga DATK me pedagogë të fushës ose të përaftërt. Elementi i dytë është organizimi i praktikës mësimore gjatë dy viteve të studimit. Kjo praktikë numëron afër 200 orë punë dhe vlerësohet me 8 kredite. Praktika është e planifikuar në strukturën e Programit të Studimit. DATK ka një lidhje dhe bashkëpunim me institucione dhe organizata jofitimprurëse të cilat ndihmojnë në kryerjen e këtyre praktikave, të cilat ndihmojnë në rritjen e cilësisë së mësimnxënies, aftësimin praktik, si dhe zotërimin e kompetencave nga ana e studentëve. <i>Evidenca, I.16.Vendimi,Nr.41dt. 24.01.2018- Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pdf;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite_compressed pdf;</i> <i>Evidenca I.7 Ngritja e GVB për programin Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë, pdf;</i> <i>Evidenca II.7 Plani mësimor i DATK i ndarë sipas krediteve në bazë të udhëzimeve të VKM nr. 41, datë 24.01.2018 ;</i> <i>Evidenca II.8 Vendim i Këshillit të Ministrave nr.436, dt. 03.06.2020, pdf;</i> <i>Evidenca I.3Aneks Tabela Përmbledhëse, Tabela 9 dhe 9/1;</i> <i>Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë,</i>
---	--

Leone 

	80/2015, neni 25, pika 8;
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Për këtë kriter, i cili përmban informacionet e nevojshme për pranimet e studentëve na janë vënë në dispozicion si GJV të gjitha dokumentacionet e nevojshme. Ky dokumentacion dhe takimi jonë me departamentin vërtetojnë se kriteret e pranimi të studentëve në DATK janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe udhëzimet e MAS. Në çdo vit akademik përgjegjësi i DATK në zbatim të statutit të UT dhe vendimit të senatit të UT dërgon në njësinë kryesore, kriteret dhe numrin e kuotave për programin e saj. Gjithashtu paraqit transferimet e studentëve në përputhje me kapacitetet e saj. Në këtë kontekst ai vendos bashkëpunim me sekretarinë për plotësimin e dokumentacionit. Të gjitha këto formalitete i vërtetojnë procedurat e ndjekura. <i>Ligji 80/2015, i Arsimit të Lartë dhe kërkimit Shkencor në Republikën e Shqipërisë, neni 25 pika 8;</i> <i>Evidenca II.8 Vendim i Këshillit të Ministrave nr.436, dt. 03.06.2020, pdf;</i> <i>Evidenca II. 9 Propozimi i kuotave për vitin akademik 2022-2023, pdf;</i> <i>Evidenca I.12 Statuti i UT, pdf;</i> <i>Evidenca II.10 Kriteret e pranimi në ciklin e parë të studimeve Bachelor dhe një program të integruar të ciklit të Dytë të Universitetit të Tiranës, pdf;</i> <i>Evidenca II. 11, Miratimi kuotave të pranimi në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor në UT, viti i studimit 2021-2022, pdf;</i> <i>Evidenca II.12 Miratimi kuotave të pranimi në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor në UT, viti i studimit 2022-2023, pdf;</i> <i>Evidenca II 5, Rregullore e Sekretarisë Mësimore të FHF. Neni 6;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Dokumentacioni që iu vu në dispozicion GJV dhe vizita në DATK treguan punën mjaft serioze të stafit akademik të këtij departamenti në përgatitjen e programeve lëndore për secilën lëndë. Që në javën e parë të procesit mësimor studentët njihen me përmbajtjen e programit, objektivat, kompetencat, organizimin e orëve mësimore në leksione dhe seminare, literaturën e detyruar dhe me zgjedhje si dhe përdorimin e fondit të bibliotekës së falutetit. Njëkohësisht nëpërmjet punonjësve të IT informohen mbi mënyrën e përdorimit të bibliotekës digjitale. Ata informohen me të gjithë komponentët e programit sipas formatit të miratuar. Studentët e njihnin mirë këtë mënyrë përshkrimi të programeve. Programet ishin jashtëzakonisht të mirëpërgatitur me tema dhe literaturë bashkëkohore dhe reflektonin të gjitha problematikat që ka sot

Leonor *[Signature]*

	Arkeologjia dhe Trashëgimia Kulturore si dhe të gjitha njohuritë e domosdoshme për formimin e studentëve me dije bashkohore. <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite në DATK, pdf;</i> <i>Evidenca II.6 Rregullore e Bibliotekës së FHF, pdf;</i> <i>Evidenca II.13 Biblioteka Digjitale JSTOR;</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga studimi i dokumentacionit dhe vizita e GVJ në DATK pamë se ata kishin si praktikë të punës së tyre që herë pas herë të përditësonin programet e lëndëve dhe leksionet. Kjo ishte gjë shumë pozitive, pasi jo vetëm që i pajisnin studentët me dije bashkëkohore, por edhe i përgatisnin për sfidat me të cilat do të përballeshin në tregun e punës. Kjo ishte një arritje e madhe në këtë departament dhe që ndihmohej shumë edhe nga pjesëmarrja e pedagogëve në projekte të rëndësishme dhe njohja me të rejtat e shkencës dhe kërkesat e tregut. Veç kësaj kishte edhe raste kur kishte ndryshime në programe, por kjo bëhej sipas rregullores së UT, që lejonte deri në 20% ndryshime. Që nga fillimi i krijimit të Departamentit, vetëm tre programe kishin kërkuar ndryshim. <i>Evidenca I.15 Rregullore e UT, pdf;</i> <i>Evidenca II.14 dryshimet në planet mësimore në ciklin e parë të studimeve Bachelor për vitin akademik 2016-2017;</i> <i>Evidenca I.3 Aneks Tabela Përmbledhëse, Tabela 11;</i>			
Konkluzione	GVJ gjykon se stafi i DATK ka bërë një punë shumë të mirë lidhur me organizimin e Programit të Studimit. Përmbajtja e programit është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe orientimet e MAS. E gjithë përmbajtja e programit realizon tërësisht objektivat e përcaktuara, të cilat lidhen me formimin akademik dhe aftësimin praktik të studentëve. Kjo gjë është realizuar duke vendosur informacionet e nevojshme në programet lëndore, duke vlerësuar lëndët me orë dhe kredite në përputhje me rolin e tyre në përmbushjen e objektivave të Programit të Studimit. Metodologjia e ndjekur në këtë drejtim është tejet shkencore dhe e bazuar në kërkesat e tregut. Gjithashtu bëhen përpjekje të vazhdueshme përditësimin e programeve dhe vënien në dispozicion të literaturës për të plotësuar njohuritë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Lesore



Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga dokumentacioni i ofruar dhe vizita e GVJ në DATK, vërejmë se që në fillim të funksionimit të Programit të Studimit, programi kishte si pikësynim pajisjen e studentëve me njohuri në fushën e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore. Njohuritë që merren nëpërmjet lëndëve që zhvillohen në nivelin e parë të studimeve janë mjaftueshëm për të formuar studentët me njohuri dhe aftësi për t'u punësuar. Në këtë departament ka përputhje ndërmjet dhënies së njohurive akademike dhe praktikave në terren. Nëpërmjet tyre mësojnë metodologjinë e punës në terren, njëkohësisht vendosin kontakte edhe me institucione të rëndësishme që merren me këto problematika dhe kanë shfaqur interes për këtë Program Studimi. Konkretisht, Ministria e Turizmit, Instituti i Arkeologjisë, Muzetë etj. <i>Evidenca I.19 Planet mësimore të miratuara me vendim Senati, pdf;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite_compressed pdf;</i> <i>Evidenca I.3 Aneks, Tabelat Përmbledhëse, pdf;</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit për GVJ dhe vizita në DATK, rezultoni i realizuar mjaft mirë. Tërësia e lëndëve dhe moduleve është konceptuar në përputhje me objektivat dhe boshtin qendror të Programit të Studimit, pra përgatitjen e specialistëve për Arkeologjinë e Trashëgiminë Kulturore. Brendia e këtyre lëndëve, apo moduleve është studiuar dhe vlerësuar për rëndësinë që ka në formimin e studentëve dhe në përputhje më të është përcaktuar edhe sasia e orëve mësimore në auditor apo studimit individual për studentët. Mbi këtë bazë janë përcaktuar kreditet për secilën lëndë apo modul. Në këtë mënyrë mendojmë se kemi realizimin e objektivave për formimin e studentëve dhe rezultatet e të nxënit. Të gjitha lëndët/modulet e Programit të Studimit në DATK të grupuara sipas rolit në formimin e studentëve në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese, padyshim që ndikojnë në formimin e njohurive të qëndrueshme për ciklin e parë të studimeve. Studimet mbyllen me mbrojtjen e diplomës dhe plotësimin e krediteve (ECTS). Në këtë mënyrë cikli i parë quhet i mbaruar.

Loosey



	<i>Evidenca I.16 Vendimi, Nr.41,dt. 24.01.2018- Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pdf;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite compressed pdf;</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në departament i GVJ mësohet se, Programi i Studimit ka të kombinuar mjaft mirë raportin teori praktikë. Kjo qasje është një zgjidhje e mirë dhe në përputhje me vetë profilin e Programit të Studimit. Ky profil programit dhe afria me programe të ngjashme ndërkombëtare mundëson dhe lehtëson transferimin e studentëve. Ky program plotëson ngarkesën me 180 (ECTS) kredite, e cila është ndarë në tre vite studimi. Departamenti ka bërë përpjekje serioze për formimin e studentëve nëpërmjet lëndëve bazë dhe karakterizuese që zhvillohen në raportin 3:1, 3 orë leksion dhe 1 orë seminar, apo lëndët ndërdisiplonare e me zgjedhje në raportin 2:1., 2 orë leksion e një orë seminar. Gjithashtu lihet e hapur mundësia e zgjedhjes së lëndëve, aty ku studentët kanë interes e dëshirë për të thelluar njohuritë, mbase në njohuri më specifike. Syllabuset e lëndëve e vërtetojnë këtë. Përmbajtja e programit të Studimit është mbështetur në përvojat e modelet e përparura të programeve të studimit për Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë në vendet fqinjë apo Bashkimit Evropian. <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite compressed pdf;</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe vizita në departament, rezulton se programi i studimit ndërthur mjaft mirë formimin akademik me atë praktik. Për vetë profilin që ka programi i studimit e ka të nevojshme këtë gjë. Kjo është materializuar në programet lëndore. Ndërthurja kryhet midis formimit teorik dhe praktikave në terren apo institucione të specializuara në TK, qofshin lokale apo qendrore. Kryhet gjithashtu nëpërmjet intershipëve dhe sistemit të krediteve (ESTC), sipas modelit Evropian, por edhe literaturës së rekomanduar dhe praktikave të organizuara nga DATK dhe që janë pjesë e kurikulës. Në këtë mënyrë studentët kanë mundësinë të përfshihen në tregun e punës brënda dhe jashtë vendit. Nga biseda me stafin dhe studentët mësuam se ata janë bërë pjesë e disa projekteve të restaurimit të organizuara nga CHWB. Këto mundësi të krijuara nga DATK, të cilat ishin shumë, ju kishin mundësuar studentëve vendosjen e kontakteve me profesorë e studentë të huaj. Edhe këtë vit do të përfshiheshin studentët në një project me vendet e Mesdheut, një mundësi më shumë për kontakte me universitete, profesorë dhe student të huaj. Edhe Diploma e

Llorenz

	lëshuar ju shton mundësitë e transferimit të studimeve, pasi ajo ka parametrat dhe standartet e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës. DATK ka shumë shëmbuj të tillë. <i>Evidenca I. 44, Memorandum Mirëkuptimi midis AADF-CHëB-DATK. dt.4. 10.2015;</i> <i>Evidenca I. 45, Memorandum Mirëkuptimi FHF-UT-CHëB dt. 21.12.2021;</i> <i>Evidenca I. 46, Vërtetime bashkëpunimi të DATK dhe CHëB për secilin projekt;</i> <i>Evidenca I.58, Përmbajtja e programit dhe syllabus Erasmus "Plus Eneas Route";</i> <i>Evidenca II.17 Udhëzim i MASR nr.10 dt.30.03.2020, Prot. 2148 dt.30.03.2020, Për përcaktimin e elementëve përbërës, Formën e Diplomës ose Çertifikatën, e lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe e procedurës së regjistrimit të tyre në rregjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor;</i> <i>Evidenca II.18 Suplementi i Diplomës Bachelor ofruar nga DATK;</i> <i>Evidenca II.19 Parametrat e standartit të Diplomës të hartuar nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës;</i> <i>Evidenca I.31 Parametrat e standartit të Diplomës, referuar sistemit të Bolonjës;</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit për grupin e GVJ, dhe vizita në departament mësuam nga afër për filozofinë e hartimit të programeve dhe mbi të gjitha përditësimin e tyre. Programet kanë në qendër procesin e të Menduarit Kritik. Në përputhje me filozofinë e të menduarit Kritik, stafi përpigje që t'i aftësonin studentët të zotëronin kompetencat në formimin akademik dhe në atë praktik. Vetë profili i programit e kushtëzonte këtë. Dijet dhe shkenca bëjnë përpara vazhdimisht dhe këta pedagogë i reflektonin përgjithësisht në programet e lëndëve apo moduleve, veçanërisht në leksione. Një gjë të tillë ua mundësonte edhe biblioteka dixhitale, të cilën e përdornin edhe studentët. E rëndësishme në këtë aspekt ishte se pedagogët reflektonin mendimet apo kërkesat e studentëve nga viti në vit. Ndihmesë në këtë process për studentët luante literatura e rekomanduar dhe leksionet e pedagogëve të cilat ofrohen me të dhënat përkatëse në syllabuse apo në sistem me formatin PDF. <i>Evidenca I.28 Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për Programin e Studimit Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor;</i> <i>Evidenca II.13 Biblioteka digjitale JSTOR;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite compressed pdf;</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit	Nga shqyrtimi i dokumentacionit për GVJ dhe vizita në Departament, arrijmë në përfundimin se kjo kurrikul është mjaft




garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	cilësore në përmbajtje. Ajo reflekton dije dhe njohuri bashkëkohore të cilat ndikojnë në formimin akademik të studentëve. Njekohësisht shohim se ndërthuren në mënyrë perfekte teoria me praktikë. Në këtë kontekst tejkalohet të mësuarit teorik dhe studentët aftësohen me kompetenca. Studentët e diplomuar në këtë program si profesionistë të rinj mund të kryejnë disa veprimtari ose punë të ndryshme si: Institucione të Trashëgimisë Kulturore, Drejtoritë Rajonale të TK, Specialistë në Parqe Arkeologjike, Prgatitës të guidave turistike, Udhërrëfyes Turistike, punonjës të muzeve, në OJF të ndryshme që merren me Trashëgiminë Kulturore, në Institucione vendore etj. Kjo larmi institucionesh punësimi flet për një program cilësor në përgatitjen e studentëve. <i>Evidenca II.7 Plani mësimor i DATK i ndarë sipas krediteve në zbatim të udhëzimeve të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018;</i> <i>Evidenca I.3 Aneks Tabela Përmbledhëse, Tabela 9, Tabela 9/1;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite compressed pdf;</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit për GVJ tregon qartë se që në fillim të projekt idesë për hapjen e programit të studimit grupi i punës ka qenë i qartë për rëndësinë, organizimin dhe funksionimin e tij. Që në fillimet e hartimit të programeve lëndore pedagogët synuan që t'u japin mjaftueshëm njohuri jo vetëm për të dalë në tregun e punës, por edhe për të studiuar më tej, master e doktoraturë më pas. Konceptet kryesore studentët i marrin që në Bachelor dhe këto mund t'i thellojnë në ciklet e tjera të studimit, kjo në varësi të interesit dhe kërkesave të studentëve. E rëndësishme është që edhe me njohuritë e marra në këtë nivel janë në gjendje të punojnë, i kanë njohuritë dhe aftësitë e duhura. Siç na treguan pedagogët gjatë vizitës në Departament, ata gjithashtu, që në fillim kishin vendosur kontakte me shumë institucione, me qëllim që t'u krijonin studentëve mundësinë e praktikave, intershipeve, punë vullnetare etj. Në këtë mënyrë studentët jo vetëm që zhvillojnë praktika, por mësojnë mënyrën e funksionimit të institucioneve me mundësi punësimi të tyre. Po kështu njiheshin edhe me kërkesat e tregut. DATK, falë edhe specifikës së tij ka mundësi dhe kontakte të shumta me këto institucione të cilat nëpërmjet programit të studimit ua përcjell studentëve duke ju krijuar mundësi të shumta punësimi. DATK ka bërë një punë shumë të mirë me përshtatjen e programeve lëndore me tregun e punës. Së bashku me studentët janë gjithmonë prezent në panairin e punës, njihen me kërkesat e tregut, në javën e këshillimit të karrierës ku

Leodeg



	marrin informacion për tregun e punës dhe vendosin kontakte me agjensitë e punësimit. Pa dyshim mund të themi se, këtë detyrë ky Departament e kryen me sukses. <i>Evidenca I.28 Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për Programin Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë;</i> <i>Evidenca I.23, Java e këshillimit të Karrierës 2022;</i> <i>Evidenca I.24 Aktivitete të FHF në kuadër të javës së këshillimit të karrierës;</i> <i>Evidenca II. 20 Programi i formimit nëpërmjet punës;</i> <i>Evidenca II.21 Panairi i Punës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, dt.26.05.2022;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite compressed pdf;</i>			
Konkluzione	<i>Organizimi i Programit të Studimit është plotësisht në përputhje me synimet dhe objektivat që ka përcaktuar DATK. Përmbajtja e kurrikulës është tejet cilësore dhe bashkëkohore dhe përgatit studentët me njohuri akademike. Në këtë program ka një ndërthurje harmonike të teorisë me praktikën duke pajisur studentët jo vetëm me dije teorike por dhe me aftësi praktike. Programi i bën studentët të aftë të zotërojnë kompetencat akademike dhe praktike në fund të studimeve. Nëpërmjet sistemit të krediteve (ESTC) ata mund të transferojnë studimet e tyre jashtë vendit. Aftësitë dhe sidomos diploma e marrë me parametrat dhe standartet e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës në fund të studimeve ju mundëson atyre punësimin brenda e jashtë vendit, gjithashtu ju le të hapur mundësinë për të vazhduar nivele të tjera të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit,	Hapja e DATK kishte si qëllim përgatitjen e specialistëve që do të punonin në fushën e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturorë. Nisur nga ky këndvështrim, Departamenti synonte të përshtaste programin sa më shumë të ishte e mundur me kërkesat e tregut. Koha në të cilën jetojmë, orientimi i zhvillimit të ekonomisë nga turizmi, e bën më të domosdoshme pikërisht këtë program me të gjithë dimensionet e tij. Në këtë

Leoneq

[Signature]

njësité përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	kontekst vërejmë se departamenti ka marrë në konsideratë propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe tregut të punës. Po të shohim me kujdes programin, dhe programet lëndore vëren se ka pikërisht lëndë apo module që, formësojnë programin në tërësi të cilat janë në përputhje pikërisht me këto kërkesa. <i>Evidenca I.23, Java e këshillimit të Karrierës 2022;</i> <i>Evidenca II.20 Programi i formimit nëpërmjet punës;</i> <i>Evidenca II.21, 21Panairi i Punës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, dt.26.05.2022;</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga dokumentacioni dhe veçanërisht nga diskutimet me stafin gjatë vizitës në DATK doli se ky institucion mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për përmirësimin e programit të studimit. Këta student, sidomos kur janë të punësuar japin ide për probleme të ndryshme, tema apo module që janë të domosdoshme. Këto kërkesa janë rezultat i punës dhe problemeve të dala aty. Në këtë kontekst merren masa për përmirësimin e programit të studimit dhe reflektimit të kërkesave apo vërejtje të bëra nga studentët e tyre ndër vite. Duke qenë se studentët punojnë në sektorë të ndryshëm edhe sugjerimet e tyre prekin shumë fusha, në të cilat mund të ketë nevojë për përmirësime apo shtesa në kurrikul. Ky bashkëpunim është tejet pozitiv për ecurinë e departamentit në vazhdimësi dhe me kërkesat e tregut. <i>Evidenca I. 17 Rregullore e DATK për organizimin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore;</i> <i>Evidenca III.8 Raport analitik i pyetësorëve të realizuar nga DATK për Programin e Studimit Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore, viti akademik 2018-2019;</i> <i>Evidenca III. 9 Raport analitik i pyetësorëve të realizuar nga DATK me studentët për programin Bachelor, viti 2021-2022, bazuar tek paketa e instrumenteve të Cilësisë, UT;</i> <i>Evidenca III.5 Paketa e instrumeneve të Cilësisë, miratuar me vendim Senati, UT, dt.13.12.2020; Pyetsorët: Vlerësimi i lëndës nga student; Vlerësimi i studentëve që diplomohen, vlerësimi për pedagogun;</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit të fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete	Njësia përgjegjëse që në këtë rast është DATK, duke marrë në konsideratë propozimet nga aktorë të ndryshëm përpikët të reflektojë sa të mundet nevojat dhe kërkesat e tyre. Veç kësaj DATK është i prirur të reflektojë zhvillimet e fundit të shkencës së Arkeologjisë e Trashëgimisë Kulturore. Ai përditëson programet lëndore, leksionet apo literaturën e përdorur për vete dhe studentët. Në këtë aspekt ka vendosur ura bashkëpunimi me rrjete




profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	profesionistësh, shoqata, institucione etj. Ky bashkëpunim ka ndikuar në përmirësimin e programeve lëndore dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e kohës dhe institucioneve përkatëse. <i>Evidenca I.15 Rregullore e UT, Neni 35, 36, 37, 38, 40, 41-mbi elementet e studimeve;</i> <i>Evidenca II.14 Ndryshimet në Planet Mësimore në ciklin e parë të studimeve Bachelor, për vitin akademik 2016-2017;</i> <i>Evidenca II.21, 21Panairi i Punës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, dt.26.05.2022;</i>			
Konkluzione	Në përfundim mund të pohojmë se DATK ka bërë një punë shumë të mirë për hartimin e programeve. Ato i përgjigjen më së miri kërkesave të tregut për specialistë të fushës së Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore. Ky Departament ka përfshirë grupe të ndryshme interesi, institucione dhe studentë të diplomuar në këtë process. Ai ka marrë në konsideratë kërkesat, vërejtjet, sugjerimet, të cilat i ka reflektuar në programet lëndore. Veç kësaj në këtë departament përditësohen njohuritë në programe dhe leksione me të reja të shkencës dhe nevojat e tregut. Në këtë mënyrë studentët përgatiten më mirë dhe i përgjigjen sfidave të tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e	Nga dokumentacioni vëmë re se në DATK personeli akademik, përdor forma të ndryshme të mësimdhënies. Të gjitha këto kanë në qendër të tyre të menduarin kritik, të nxënësit në bashkëpunim me qëllim që studentët jo vetëm të formohen në aspektin akademik, por edhe të aftësohen në zotërimin e kompetencave. Vetë profili i programit ka si objektiv aftësimin profesional të studentëve. Të gjitha këto janë parashikuar në

Leoneel'

[Signature]

kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	kurikulën e programit të studimit, por edhe në strategjinë e UT. Lëndët në programin e studimit organizohen sipas kategorive të përcaktuara në VKM 41. Leksionet dhe seminarët zhvillohen nëpërmjet shpjegimit, bisedës, diskutimit etj. Kjo në varësi të lëndës, krediteve që ka. Nuk mungojnë edhe rastet kur për tema specifike, ftojnë specialist të fushës. Përdoret edhe power point. Zakonisht lejohet diskutimi në grup apo individual, me qëllim që studentët të artikulojnë vetë, por dhe të ngrenë probleme. Punët e laboratorit, janë edhe ato mjaft të rëndësishme, zenë gati 25% të lëndëve. Janë ato orë ku studenti mësohet të punojë dhe të fitojë aftësi për punë në terren. Këtu mëson për herë të parë metodologjinë e punës në terren. Mëson metodat praktike në metodologjinë e gjeoarkeologjisë, teknologjisë antike, konservimit etj. Labororet e programit ishin perfekt, të fjalës së fundit të shkencës, dhe ndihmojnë cilësisht në këtë drejtim. Detyrat e kursit janë një tjetër mënyrë për formimin akademik dhe me punën e pavarur për studentët. Këto detyra janë vendi ku studentët shfaqin mendimin e tyre, nëpërmjet interpretimeve. Mësohen të shfrytëzojnë literaturën, familjarizohen me bibliotekat. Në këto detyra ju që zhvillohen që në vitin e parë të studimeve, ju kërkohet që të zbatohen parimet e strategjisë së të Menduarit Kritik. Jo më pak të rëndësishme janë praktikat mësimore, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në familjarizimin e studentëve me profesionin, në arkeologji apo TK. Njëkohësisht nisur nga objektivat mësimore i aftëson në zotërimin e kompetencave akademike e praktike. <i>Evidenca I.13 Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2032, pdf;</i> <i>Evidenca I.19 Planet mësimore të miratuara me vendim Senati, pdf;</i> <i>Evidenca I.3 Aneks Tabela Përmbledhëse;</i> <i>Evidenca I.16 Vendim Nr.41, dt. 24.01.2018, Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pika 2.1.d;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite compressed pdf;</i> <i>Evidenca III.14 Syllabusi i Lëndës Shkrim Akademik, DATK, FHF, UT;</i> <i>Evidenca I.28 Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për Programin Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë;</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve,	Nga biseda me pedagogët e DATK pamë se ata punonin me përkushtim për realizimin e objektivave të Programit të Studimit. Personeli akademik u përgjigjej me korrektesë nevojave të studentëve me metoda nga më të ndryshme në

Licenses

[Signature]

duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	procesin e mësimdhënies. Personeli akademik gjithashtu është i ndërgjegjshëm për problematikat e studentëve, për kushtet apo nevojat e tyre. Ata shpesh përpiqen të adresojnë problemet në departament, por dhe instanca të tjera. Njëkohësisht ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të tyre. Ata i ndihmojnë me leksione, literaturë, për detyrat, mjafton që ata të ndjehen mirë dhe të respektuar. Madje jo vetëm kaq, por përdorin dhe metoda e mundësi alternative, mjafton që studentët të përfshihen në mësimdhënie. Personeli akademik ka respektuar dhe ruajtur dinjitetin dhe integritetin e studentit me aftësi ndryshe. Po këtë filozofi kanë edhe në raportet e studentëve nga etni të ndryshme, apo dhe orientim seksual ndryshe. Të ruajnë dhe respektojnë të drejtat e tyre. Këta pedagogë, siç doli edhe nga biseda me studentët janë tepër të sjellshëm dhe të komunikueshëm me studentët. <i>Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, neni 4, pika 3;</i> <i>Evidenca I.17 Rregullore e DATK për organizimin e programit të ciklit të parë të studimeve bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor, pdf;</i> <i>Evidenca I.13 Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2032, pdf;</i> <i>Evidenca I.32 Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës. Detyrimet e punonjësve, neni 4, pika j;</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet Personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave të tij akademike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Personeli akademik në DATK na konfirmoi se ata kishin mbështetje nga institucioni në drejtim të përmirësimit të aftësive të tyre didaktike. Kjo bëhej me qëllim që të ishin sa më të aftë në përmbushjen e objektivave të departamentit për një mësimdhënie sa më interactive dhe që më pas të kishin rezultatet e pritshme. Objektivi i tyre ishte të aftësonin studentët në pikëpamje akademike dhe formimin e kompetencave praktike. Përveç metodës së leksionit ju krijohehin mundësi të përdornin mjete dixhitale për përdorimin e poëer point, aparaturat audiovizive etj., me qëllim që të bënin një shpjegim më analitik të problemeve specifike apo që paraqesnin vështirësi. Në seminare përdornin diskutimin dhe debatin, parashtrisa të pikëpamjeve apo mendimeve që kërkonin diskutim. E veçanta ishte se përdornin gjerësisht edhe laboratorin e DATK, por edhe jashtë tij, si në Institutin e Fizikës Bërthamore, Galerinë e Arteve për konservimin, lab e Arkeometrisë, në fakultetin e Gjeologji Miniera etj. Rëndësia e këtyre veprimtarive qëndron në faktin se njohuritë, konceptet bëhen të prekshme. Të gjitha këto janë referuar edhe në RVB. <i>Evidenca I.13 Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2032, pdf.</i> <i>Mësimdhënia dhe Studimet, Strategjitë e zbatimit;</i>

Leodeeq

	<i>Evidenca III.16 Vendimi Nr.1, dt. 01.10.2021, për miratimin e Financimit të projekteve –Fituese të infrastrukturës së kërkimit Shkencor, për vitin 2021;</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i DATK që është angazhuar në mësimdhënie ishte tepër kompetent për dhënien e njohurive. Ata mbanin tituj Prof. Dr., Prof.As. Dr., dhe jo vetëm kaq por ishin shumë të kualifikuar në specialitetin e tyre. Kishin kryer studime të niveleve të ndryshme në BE dhe ShBA. Si filozofi të mësimdhënies ata kishin strategjinë e të Menduarit Kritik nëpërmjet Shkrimit dhe Leximit. Kjo do të thotë se ata gjatë orës së mësimi, leksione apo seminare nxisnin diskutimin dhe mendimin krijues të studentëve. Nuk mjaftoheshin thjesht dhe vetëm me ritregimin e njohurive, por kërkonin që të thelloheshin në të. Mbi të gjitha kërkonin, analizën, krahasimin, argumentin dhe vlerësimin e procesit në kontekstin përse më hyn në punë kjo njohuri apo ky koncept. Mendimet ishin të pavarura. Edhe në punimet e diplomave pedagogët kishin si synim të edukonin punën e pavarur, mendimin e tyre, forcën argumentuese dhe interpretuese. Studentët t'i aftësojnë të shkruajnë. Gjithashtu ata organizonin edhe punën në grup, kjo me qëllim që studentët të këmbenin mendime, por edhe të nxisnin bashkëpunimin midis tyre. Të nxënësit në bashkëpunim ishte një tjetër pikësypnim i stafit pedagogjik. Në këtë mënyrë studentët respektonin njëri-tjetrin, mendimin e tyre, por edhe pedagogët bëheshin pjesë e kësaj marrëdhënieje. Gjatë mësimdhënies studentët përfshiheshin në diskutime. Ishin pjesë e punës së pavarur në laboratore apo institucione dhe projekteve ku mësoheshin të aplikonin në praktikë apo terren ato që mësonin në auditor. Ishin pjesë e praktikave mësimore ku zbatonin njohuritë e marra, por dhe përballeshin me të reja të terrenit. Punët e pavarura të temave të diplomës apo detyrave të kursit. Ata kishin vendosur me studentët marrëdhënie respekti midis tyre. Të gjitha këto dolën nga diskutimi i GVJ në DATK. <i>Dokumenta shtesë 11;</i> <i>Evidenca III.30 Trajnim mbi platformën Microsoft Teams for Education për zhvillimin e mësimi online, Njësitë Kryesore të UT;</i> <i>Evidenca I.39 Marrëveshje bashkëpunimi me AADF dhe UT, për projektin Clean Score;</i> <i>Evidenca I.40 Raporti i implementimit të projektin Clean Score, pdf;</i> <i>Evidenca I.42 Projekti Clean Score në DATK;</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e	DATK si njësi, pedagogët në përgjithësi janë përpjekur vazhdimisht për të përmirësuar format e metodat e

Leon

programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	mësimdhënies. Për ta ka qenë sfidë mësimdhënien me metodat bashkëkohore, duke investuar përpjekje të vazhdueshme. E rëndësishme është se ata në këtë proces kanë përfshirë edhe studentët, duke i bërë pjesë. Si rezultat ata kanë reflektuar sugjerimet e tyre. Përgjithësisht kërkesat apo sugjerimet janë në lëndë specifike, si shkrimi akademik, lidhur me citimet, bibliografinë, shkrimin e paragrafëve, interpretimet etj. Ata ndër vite kanë kërkuar më shumë praktikë apo ngritje laboratory, i cili u finalizua falë projektit të vetë DATK. Ky departament është i gatshëm në çdo moment të marrë në konsideratë çdo sugjerim dhe kërkesë të studentëve me qëllim që mësimdhënien të arrijë në standartet më të përparura të kohës. <i>Evidenca I.32 Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës; Dokumentacioni shtesë, nr. 7,8,9,10; Evidenca III.5 Paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga Senati i UT dt.13.12.2020;</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Elementi që vlerësohet në raport është fakti që, Institucioni ka pasur në qendër të vëmendjes promovimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, duke e parë si elementin e rëndësishëm të cilësisë. Në përputhje të plotë me Ligjin për Arsimin e Lartë, dhe kodin e cilësisë në arsimin e lartë, FHF ka ngritur NJSCB (Njësia për Sigurimit e Brendshëm të Cilësisë). Kjo njësi ka rolin kryesor për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Nga biseda me personelin akademik dhe RVB (raportin e vlerësimit të brendshëm) pamë se ka përpjekje të vazhdueshme nga ana e NJSCB që personeli akademik të trajnohet për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. DATK është në kontakte të vazhdueshme me këtë njësi për aktivitete trajnuese dhe pajisjen e pedagogëve të saj metoda të reja të mësimdhënies. <i>Evidenca II. 4 Rregullore e NJSCB të FHF; Evidenca II. 4, Rregullore e NJSCB të FHF, Neni 4, pika 2,3; Evidenca III.30, Trainim mbi platformën Microsoft for education për zhvillimin e mësimin online në Njësitë Kryesore të UT; Evidenca I.39 Marrëveshja e Bashkëpunimit AADF dhe UT për projektin Clean Score, pdf; Evidenca I.40 Raporti i Implementimit të Projektit Clean Score, AADF, pdf; Evidenca I.42 Projekti Clean Score në DATK, pdf;</i>
Konkluzione	Fakulteti dhe Departamenti kanë përpjekje mjaft serioze dhe të vazhdueshme për përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Strukturat i kanë mbështetur vazhdimisht në këtë aspekt, duke i parë të lidhura drejtpërdrejt me rritjen e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies. Personeli i DATK është

Leona

	përfshirë në trajnime herë pas here gjë që i ka ndihmuar në realizimin e objektivave për një mësimdhënie sa më cilësore. Ata gjithashtu kanë përfshirë në këtë process edhe studentët, të cilët me sugjerimet e tyre kanë treguar qfarë duan më shumë dhe ç'duhet bërë më mirë. Staf i akademik është i hapur për t'i paraprirë ndryshimit. Në këtë kontekst gjithashtu vihet re një marrëdhënie e mirë dhe respekti të ndërsjelltë midis studentëve dhe pedagogëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në fund të procesit mësimor, për të parë se sa cilësor ka qenë, është vlerësimi i njohurive të studentëve, DATK ka bërë përpjekje që vlerësimi të jetë sa më korrekt, i saktë dhe transparent. Në këtë kontekst departamenti në përputhje me VKM nr.41 dhe rregulloren e UT, ka hartuar rregulloren e tij. Që në fillim të semestrit studentët njihen me përmbajtjen e programit, detyrimet për lëndën, labororet, leksionet, seminarat, detyrat e kursit, mënyrën e punimit të tyre, por edhe me vlerësimin. Vlerësimi është i vazhduar gjatë seminareve ku studentët diskutojnë leksionet, literaturën, detyrat, punët e laboratorit, etj. Studentët gjithashtu njihen e dhe me detyrimet që kanë në procesin mësimor. Studentët në leksione mund të ndjekin 75% të tyre, kurse në seminare duhet të jenë prezent në masën 75%. Edhe në këtë drejtim ata kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme, midis të cilëve përmendim seminarin e organizuar nga UT lidhur me kualifikimet e kornizës shqiptare të përshtatur me ato Evropiane. Seminari ju shërben për të përshatur syllabuset, pse jo edhe procesin e vlerësimit me praktikatat Evropiane. Pedagogët e departamentit na konfirmuan se janë present në të gjitha trajnimet e kësaj natyre dhe përpiqen t'i inplementojnë në dokumentacionin dhe punën e tyre. E gjithë kjo praktikë pasqyrohet edhe në RVB dhe u konfirmua gjatë vizitës në institucion. <i>Evidenca I.17 Rregullore e DATK për organizimin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor;</i> <i>Evidenca III.8 Raport analitik i pyetësorëve të realizuar nga DATK për Programin e Studimit Bachelor në Arkeologji dhe</i>

Leoneq'

[Signature]

	<i>Trashëgimi Kulturore, viti akademik 2018-2019;</i> <i>Evidenca I.16 Vendim Nr.41, dt. 24.01.2018, Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë. Neni 2.2 a,b,c,ç;</i> <i>Evidenca I.15, Rregullore e UT, neni 35,36,37,38,40, 41;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite_compressed pdf;</i> <i>Evidenca I.15 Rregullore e UT, pdf;</i> <i>Evidenca III.31 Seminar i zhvilluar nga Qendra Virtuale e zhvillimit profesional dhe Trajnimit në UT, në kuadër të zbatimit të procesit të Bolonjës. Pdf;</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Grupi i vlerësimit të jashtëm vëren se departamenti ka bërë një punë shumë të mirë lidhur me metodologjinë dhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Këtë veprim pedagogët e bëjnë prezent që në takimin e parë në auditor, ku paraqisin mënyrat e vlerësimit. Kështu na u konfirmua nga pedagogët e DATK dhe nga RVB. Studentët vlerësohen në vazhdim nëpërmjet seminareve, detyrave të kursit, laboratoreve etj. Ata kanë si metodë vlerësimi edhe provimin e ndërmjetëm dhe atë në fund të semestrit. Provimi apo testimi në fund të semestrit ka për qëllim të vlerësojë njohuritë por dhe kompetencat e shprehite aplikative të studentëve, gjithashka që përshkruhet në syllabuset e lëndës. Një vënd jo më pak të rëndësishme në vlerësim zenë edhe detyrat apo projektet në grup. Testimet aplikohen në lëndët që kanë përmbajtje në dokumentin. <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite_compressed pdf;</i> <i>Evidenca I.42 Projekti Clean Score në DATK, pdf;</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Nga pedagogët gjatë vizitës në DATK dhe RVB mësuam se i kushtonin një vëmendje të posaçme vlerësimit të njohurive të studentëve. Vlerësimi bëhej nëpërmjet testeve me shkrim e gojë, detyrave projekteve, laboratoreve etj. Pedagogët kujdeseshin që testet apo detyrat të kishin mundësi ku studentët të shprehnin njohuritë, por mbi të gjitha aftësitë dhe kompetencat e fituara gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies. Veç kësaj pedagogët kërkojnë që edhe testi përveç pyetjeve me pohime, të këtë në qendër të menduarin kritik, në vlerësimin e procesit të testimit. <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite_compressed pdf;</i> <i>Evidenca I.42 Projekti Clean Score në DATK, pdf;</i> <i>Evidenca I.40 Raporti i implementimit të projektit Clean Score, AADF, pdf;</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik	Departamenti dhe personeli akademik kanë në qendër të vëmendjes përpjekjet për të përmirësuar metodat e

Leoreq

[Signature]

vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimit në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	mësimdhënies. Nisur nga përmbajtja e lëndës dhe veçoritë specifike të secilës, pedagogët përcaktojnë edhe metodat e mësimit. Ata janë fleksibël dhe me eksperiencën e duhur në këtë drejtim prandaj dhe bëjnë zgjedhjet e duhura. E rëndësishme është se ata në këtë proces përfshijnë edhe studentët, gjatë shpjegimit apo vlerësimit të tij. Kërkojnë mendime se si ka ecur procesi i mësimit dhe a ka nevojë për përmirësim si dhe ku. Pedagogët janë të hapur dhe respektojnë mendimet e studentëve dhe i reflektojnë sipas mundësive dhe mjeteve në dispozicion. <i>Evidenca II. 4 Rregullore e NJSCB të FHF;</i> <i>Evidenca II. 4, Rregullore e NJSCB të FHF, Neni 4, pika 2,3;</i> <i>Evidenca III.30, Trainim mbi platformën Microsoft for education për zhvillimin e mësimit online në Njësitë Kryesore të UT;</i> <i>Evidenca I.39 Marrëveshja e Bashkëpunimit AADF dhe UT për projektin Clean Score, pdf;</i> <i>Evidenca I.40 Raporti i Implementimit të Projektit Clean Score, AADF, pdf;</i> <i>Evidenca I.42 Projekti Clean Score në DATK, pdf;</i> <i>Evidenca III.8 Raport analitik i pyetësorëve të realizuar nga DATK për Programin e Studimit Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor, viti akademik 2018-2019;</i> <i>Evidenca III.9 Raport analitik i pyetësorëve të realizuar nga DATK me studentët për programin Bachelor, viti 2021-2022, bazuar tek paketa e instrumenteve të Cilësisë, UT;</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	FHF e ka pasur në qendër të vëmendjes procesin e mësimit dhe për këtë ka bërë përpjekje për të përmirësuar procesin. Brënda lirisë akademike, institucioni ju mundëson pedagogëve përdorimin e metodave të shumëllojshme të përshtatshme në procesin e mësimit. Ai ka pasur parasysh që këto metoda të jenë të përshtatshme dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve, formimit me njohuri akademike dhe aftësimin me kompetenca. Nga ana tjetër metodat e ndryshme të mësimit nxisin dhe inkurajojnë autonominë tek studentët, sidomos në aspektin e të mësuarit dhe përgjigjeve. Kjo mënyrë e mësimit ndikon edhe në vendosjen e marrëdhënieve e respektit të ndërsjellë ndërmjet studentëve e pedagogëve. Dhe këtë personeli i DATK ja ka arritur me sukses. Ata janë të komunikueshëm, respektojnë studentët dhe të hapur për të pranuar çdo sugjerim apo kërkesë nga ana e tyre. Këtë e konfirmon dokumentacioni dhe vizita e GJV në department, biseda me pedagogët. <i>Evidenca III.30 Trainim mbi platformën Microsoft for education për zhvillimin e mësimit online në Njësitë</i>

Leonor



	Kryesore të UT; Evidenca I.39 Marrëveshja e Bashkëpunimit AADF dhe UT për projektin Clean Score, pdf; Evidenca I.42 Projekti Clean Score në DATK, pdf; Evidenca III.8 Raport analitik i pyetësorëve të realizuar nga DATK për Programin e Studimit Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë, viti akademik 2018-2019; Evidenca III.9 Raport analitik i pyetësorëve të realizuar nga DATK me studentët për programin Bachelor, viti 2021-2022, bazuar tek paketa e instrumenteve të Cilësisë, UT;			
Konkluzione	Institucioni ka bërë përpjekje në vazhdimësi për të përmirësuar metodat e mësimdhënies. Po kështu DATK ka qenë i angazhuar në krijimin e standarteve sa më të mira dhe të studiuarat për vlerësimin e studentëve. Metodatat e vlerësimit janë nga më të studiuarat dhe kanë si synim që, studenti të nxjerrë në pah njohuritë akademike dhe njëkohësisht aftësitë praktike në zotërimin e kompetencave. Format e testeve janë nga më të avancuarat dhe të pranueshme nga studentët, janë gjithashtu edhe gjithëpërfshirëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Programi i studimit në DATK është në përputhje me vitin kalendarik të përcaktuar nga Njësia Kryesore. Ministria e Arsimit dhe Sporteve përcakton datën e fillimit dhe mbarimit të vitit akademik. Gjithashtu cakton edhe dy sezona të rregullta për testimin e studentëve, në përfundim të semestrit. Studentëve ju krijohen edhe mundësi për riprovime me minisezone. Testimi ose provimi ka për qëllim të provojë apo dëshmojë për njohuritë që ka studenti. Sipas përcaktimit të Ministrisë të krijohet ideja sikur studentët provohen 2 apo 4 herë. Njësia kryesore për t'ju ardhur në ndihmë studentëve të vitit të fundit, kur kanë tre provime të mbartura cakton tre minisezone. Në DATK testimi e vlerësimi i dijeve realizohet gjatë gjithë kohës së studimit. Sipas rregullores së UT dhe DATK frekuentimi në leksione dhe seminare është i detyrueshëm më së paku 70% të orëve mësimore në leksione e seminare. (ka një luhatje të vogël me rregulloren e UT, por besoj se kanë pak tolerancë në departament, të cilën ua njeh edhe rregullorja e UT).

Leones



	Nëse studenti bën më shumë se 30% mungesa të orëve në seminare, në një lëndë, në proces verbal shënohet: nuk ka frekuentuar, duhet pa tjetër që të përsërisë frekuentimin e lëndës. Sipas rregullores së DATK, kur studenti ka frekuentuar nga 50-75% të orëve të seminareve, studenti ka të drejtë të futet ne provim, në sezonin e vjeshtës. Kontrolli i vazhdueshëm i njohurive iu krijonte mundësi pedagogëve të kontrollonin njohuritë dhe aftësitë në çdo orë seminari. Studenti është i detyruar të dorëzojë detyrën e kursit në afatin e përcaktuar. Edhe përgjigjet apo leximet e gjetjeve në literaturë apo gjatë përgatitjes duhet të kumtohen në auditor. Përgjigjet janë të orientuara, nëpërmjet pyetjeve apo të lira, nëpërmjet interpretimeve të studentëve. Këto përgjigje kanë 20% të vlerësimit përfundimtar. Gjithashtu studenti është i detyruar të japë një punim të shkurtër mbi të zhvillimet e reja në aspekte të ndryshme të zhvillimeve historike (sipas fushave që dëshiron, kryesisht në ato të programit). Ky punim duhet të jetë origjinal dhe jo plagjiaturë, i shkruar sipas rregullave të shkrimit akademik. Kjo detyrë vlerësohet me 10% të pikëve të përgjithshme. Format e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive ishin, aktivizimi në diskutime, detyra e kursit, një provim i ndërmjetëm, qoftë edhe me detyrë që ju kërkohej dhe provimi përfundimtar. Ky provim në mënyrë të sintetizuar përmban lëndën e zhvilluar në semester dhe ka 70% të pikëve të vlerësimit përfundimtar. Kjo formë e kontrollit ishte e parashikuar edhe në syllabuset, madje përcaktohej edhe pesha që zinte secila mënyrë e kontrollit. Konkretisht Kontrolli i vazhdueshëm reflektohej në vlerësimin përfundimtar sipas masës së përcaktuar. Edhe detyrat, projektet, labororet vlerësoheshin hap pas hapi. Këto u konfirmuan edhe nga pedagogët për GVJ. <i>Evidenca II.16 Struktura Akademike e FHF për vitin akademik, 2021-2022, pdf;</i> <i>Evidenca II.15 EV88-7D, EV88-7D, PDF;</i> <i>Evidenca I.20, Syllabuset e lëndëve të ofruara nga në vite në DATK, pdf;</i> <i>Evidenca I.17 Rregullore e DATK për organizimin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore; neni nr.7, 10.pdf.</i> <i>Evidenca I.15, Rregullorja e UT, neni 7 dhe 10, pdf.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të	Pedagogët dhe raporti i GVB tregoi se në DATK kishin përdorur edhe forma elektronike të testimit. Kjo bëhej e mundur në lëndët që kërkonin përgjigje të mbyllura. Konkretisht ato kanë përdorur cleascore e cila sipas pohimit të pedagogëve ju kishte rezultuar efektive. Një tjetër metodë




ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	elektronike ishte Microsot Teams dhe krijimit të tezave në Forms. Kjo ishte sidomos efektive kur u krye mësimi online, por edhe sot kishte raste, sidomos të ndërmjetmet i bënë me këtë formë. Në fakt zgjedhja e këtyre formave shmanget abuzimin dhe rrit transparencën. Por të gjitha nuk mund të bëhen, vetë karakteri i provimit të njohurive dhe aftësive e kushtëzon këtë. Provimet e semestrit i zhvillonin në auditor. <i>Evidenca I.42 Projekti Clean Score në DATK, pdf;</i> <i>Evidenca III.32 Udhëzues i UT për përdorimin e sistemit të mësimi në distancë, pdf;</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Gjate procesit mësimor, një moment i rëndësishëm është edhe ai i vlerësimit të njohurive. Fillimi dhe mbarimi i vitit akademik përcaktohet nga Njësia Kryesore, pasi Ministria e Arsimit ka përcaktuar kalendarin e vitit akademik. Testimi dhe vlerësimi i njohurive bëhet dy here në vit, verë dhe dimër. Studentëve ju krijohen edhe tri minisezone, (verë, vjeshtë dhe dimër). Studenti hyn në provimin e lëndës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet. Kjo d.m.th. ka qenë pjesëmarrës në leksione dhe seminare, sipas parashikimit në rregullore, ka marrë pjesë me diskutime në seminare, ka bërë detyrat e kursit, siç pëshkruhet në rregulloren e DATK dhe në syllabusin e lëndëve. Pjesëmarrja në leksione nga DATK është edhe facultative, por për lëndë specifike, të veçanta është i detyruar të ndjekë 70-75% të orëve. Vlerësimi përfundimtar i lëndës apo modulit, bëhet me provim (testim) në auditor. Prezent janë dy pedagogë, njëri domosdoshmërisht i lëndës dhe tjetri po nga departamenti dhe merret me mbarëvajtjen e procesit. Zakonisht testimet i bënin me shkrim, por kishte edhe raste, sipas specifikës së lëndës kur i kombinonin. Në përfundim studentët orientohen për provimin, që nga mënyra e zhvillimit deri tek problemet kryesore të lëndës, ku do e venë theksin më shumë. <i>Evidenca I.17 Rregullore e DATK për organizimin e e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore, Neni 10;pika 2, pdf</i> <i>Evidenca I.17 Po aty, Neni 12;</i> <i>Evidenca I.20, Syllabuset e lëndëve të ofruara nga në vite në DATK, pdf;</i> <i>Evidenca I.15, Rregullorja e UT, neni 7 dhe 10, pdf.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe	Mëyra e vlerësimit është e përshkruar edhe në syllabuset e çdo lënde. Që në fillim së bashku me njohjen e programit (syllabusit) studentët njihen edhe me mënyrën e vlerësimit me qëllim që të vlerësojnë procesin e të nxëniet. Nga dokumentacioni që lexuam, takimi në DATK me pedagogët dhe veçmas takimi me studentët vlerësuam se, ky departament ka

Leoree;



lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	dy mënyra për dhënien e vlerësimit të studentëve në dy mënyra, me sistemin Microsoft Teams dhe me gojë. Me mënyrën e parë vlerësohen me pikë të gjitha pyetjet dhe shuma përkthehet në notë. Fillimisht ju jepet tabela me pikët për secilën pyetje dhe studenti është i informuar paraprakisht për këtë. Nëse ka ankesa studentëve ju krijohet mundësia për t'i parë provimet, ku bëhet analiza e korigjimeve dhe jepen vërejtjet një për një, duke bërë që studentët të reflektojnë për të ardhmen. Bëheshin edhe vlerësimet për provime apo studentët që kishin punuar mirë apo dhe ku duhej të kishin kujdes ata që kishin shfaqur probleme. Gjithashtu studentët këshilloheshin se si të përmirësonin në të ardhmen punën e tyre në mësuar dhe në testime. Në rastin e dytë bëhet e njëjta procedure veçse jo në sistem, por me gojë. Gjëja pozitive që ne vlerësuam ishte se nota në sistem hidhej pasi ju tregohej studentëve më parë. <i>Evidenca I.17 Rregullore e DATK për organizimin e ciklit të parë të studimeve në Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor, pdf;</i> <i>Evidenca I.15 Rregullore e UT, pdf;</i> <i>Evidenca I.20, Syllabuset e lëndëve të ofruara nga në vite në DATK, pdf;</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga takimi që bëme gjatë vizitës në DATK dhe takimit me pedagogët mësuam se, nga përvoja e viteve kishin vënë re mangësi në procesin e të shkruarit dhe se shpesh herë studentët kopjonin në detyra pse jo dhe në provime. Me pak fjalë nuk dinin të shkruanin me rregulla akademike. Ky fenomen vërehej edhe në temat e diplomave, sidomos në Bachelor. Për këtë arsye dhe sidomos për të shmangur kopjimin, DATK, vendosi që të bëjë pjesë të programit të studimit lëndën "Shkrim Akademik". Duke parë syllabusin e kësaj lëndë mësojmë se është tepër analitik. Studentët mësojnë si të lexojnë në mënyrë akademike deri dhe të shkruajnë në mënyrë akademike. Mësojnë rregulla të tilla që nga hartimi i paragrafëve, interpretimi i fakteve, konstruktin e fjalive, kohët e foljes, mënyrat e ndryshme të citimeve, hartimin e bibliografsë, shkrimin e artikujve shkencorë etj. Në këtë kontekst të gjithë pedagogët e lëndëve që kanë detyra, esse për të bërë ju kërkojnë zbatimin e rregullave të shkrimit akademik me qëllim që studentët të shmangnin plagjiaturën, pasi kanë penalitete. Paraprakisht edhe ata vetë i orientojnë me rregullat e shkrimit dhe ndershmërisë akademike. Në këtë mënyrë mendojmë se kanë mundur të shmangin plagjiaturat dhe kopjimin e detyrave. Kjo ishte për t'u vlerësuar dhe këtë e konfirmon edhe RVB. <i>Evidenca III 14 Syllabusi i Lëndës Shkrim Akademik në, DATK,</i>


Leolueq' 

	<i>FHF, UT, pdf;</i> <i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite compressed pdf;</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	DATK zbatonte me rigorozitet orientimet e dhëna nga Njësia Kryesore lidhur me vlerësimin e studentëve. Nga dokumentacioni, vizita në departament, takimi me studentët mësuam se pedagogët ishin tepër korrekt për kohën e korigjimit të provimeve. Nuk kalonte më shumë se dy javë nga dita e kryerjes së provimit dhe vlerësimet studentëve ju komunikoheshin. Nuk kishte pasur asnjë rast të shkeljes së udhëzimit, asnjë ankesë nga studentët. <i>Evidenca I.17 Rregullore e DATK për organizimin e ciklit të parë të studimeve në Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore, pdf;</i> <i>Evidenca I.15 Rregullore e UT, pdf;</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Rregulli i Njesisë Kryesore lidhur me të drejtën e studentëve për rishikimin e provimit ishte plotësisht i zbatueshëm dhe me rigorozitet. Fillimisht njiheshin studentët me vlerësimin me të drejtëm për të parë atë dhe për të shprehur pëlqimin. Në se kishte ndonjë pakënaqësi, studentët kishin të drejtën të kërkonin rishikimin e provimit në përputhje me rregullat. Pas daljes së rezultateve, pedagogu konform rregullores për procedurat e vlerësimit prët studentët për të sqaruar çdo ankesë apo pretendim të mundshëm për vlerësimin. Në se nuk ka ankesa, pedagogu dorëzon Process Verbalin në sekretari. Në rastet kur studenti ka pretendime të argumentuara atëhere nga DATK ngrihej një komision vlerësimi që shqyrtojnë kërkesën. Në komisionin e vlerësimit është pedagogu i lëndës, asistenti në se ka, ose një pedagog tjetër i departamentit i afërt me fushën. Nëse studenti nuk bindet ankesa shqyrtohet nga një tjetër komision i posaçëm. Ky komision ngrihej me urdhër të përgjegjësit të departamentit dhe në përbërje ka pedagogë të tjerë të përafërt të fushës, nuk është pedagogu i lëndës për të mos krijuar probleme. Në këtë mënyrë mendojmë se vlerësimi dhe rikorigjimi janë tejet transparent. Rast konkret është i students Ina Rapushaj, për lëndën Antropologjia Social Kulturore, me pedagoge Esmeralda Agolli. Komisioni i ngritur me vendim të përgjegjësit të DATK, pas verifikimit nuk gjeti shkelje, dhe la vlerësimin e pedagogut të lëndës. <i>Evidenca I.17 Rregullore e DATK për organizimin e ciklit të parë të studimeve në Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore, pdf; Neni 10, pika 2/5.</i> <i>Evidenca I.15 Rregullore e UT, pdf;</i>

Leoreg 

	Evidenca III.33 Procedura e ndjekur nga DATK në rast të ankimit të vlerësimit, pdf; Kërkesa e students Ina Rapushaj.			
Konkluzione	Në përfundim GVJ gjykon se procesi i vlerësimit të studentëve është i bazuar në ligje dhe rregullore, madje ai është parashikuar edhe në programet lëndore. DATK ka mënyra të ndryshme të vlerësimit dhe përpqet që ai të jetë jo thjesht një testim tregues apo pohues, por të tregojë formimin e studentëve më aftësi akademike dhe kompetenca. Në këtë kontekst bëhet kujdes që të shmanget kopja apo plagjiatura. Është lëndë e veçantë që ju mëson rregullat e të shkruarit akademik, por edhe pedagogët bëjnë punë në lëndët e tyre për këtë gjë. Procesi i vlerësimit është transparent. Ai monitorohet dhe departamenti ngre struktura të veçanta për procesin. Pedagogët kishin në filozofinë conform rregulloreve se, të mësuarit është process dhe se në auditor, dallimet midis problemeve të metodave të mësimdhënies, menaxhimit, motivimit dhe vlerësimit pothuaj asnjëherë nuk janë të ndara nga njëra tjetra.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i Studimit, ka si qëllim përgatitjen e specialistëve të fushës së Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore me njohuri të thella dhe specifike. Këto njohuri, në ndryshim nga disa njohuri që merreshin më parë në programin e Historisë, do të garantonin thellimin e njohurive akademike, por do të aftësonin ata të zotëronin kompetenca profesionale. Shqipëria kishte nevojë për këta specialist dhe ishte ky Program Studimi që mund ta bënte këtë gjë. Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve sipas kategorive në ECTS për programin e studimit është si më poshtë:			
	Kategoria	Tipi	ECTS	%
	A	Lëndë Bazë	36	20%
	B	Lëndë karakterizuese	94	52.2 %
	C	Lëndë ndërdisiplinore /	32	17.7 %
				Standardi
				15-20 %
				50-55 %
				12-15 %



	integruese			
D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	12	6.6 %	10-15 %
E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar	6	3.4 %	3-5 %

Shqyrtimi i tyre tregon, se gjenden më shumë lëndë mësimore të kategorisë C (Lëndë ndërdisiplinore) në Planin Mësimor të shprehura në 17.7 % të krediteve, në raport me 12% - 15% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori;

Si dhe, gjenden më pak lëndë mësimore të kategorisë D (Lëndë plotësuese) në Planin Mësimor të shprehura në 6.6 % të krediteve, në raport me 10% - 15% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;

Për sa më sipër GVJ sugjeron, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite me qëllim që të përputhet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.

Sipas bisedës me pedagogët gjatë vizitës në DATK ata synonin që t'i formonin studentët në aspektin teorik, por edhe aftësonin me metodologjinë e punës në fushat përkatëse, kjo bëhej nëpërmjet lëndëve karakterizuese. Studentët duhej të afroreshin më afër fushës së ekspertizës në fushën e arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore. Veçanërisht lëndët që kishin laboratore dhe praktika në terren i aftësonin studentët për monitorim në gërmimet arkeologjike, restaurim, inventarizim të pasurive të TK, konsevimi etj. Kurse punimi i temës së Diplomës, është një hap cilësor, që tregon se sa nxënësit i kanë përvetsuar njohuritë, janë në gjendje të shkruajnë sipas rregullave të shkrimit akademik, të paraqisin kërkime në terren, të punojnë në mënyrë të pavarur dhe bosht i gjithë punës së tyre të jetë strategjia e të Menduarit Kritik, nëpërmjet Shkrimit dhe Leximit. Dhe këtë DATK e kishte arritur.

Evidenca II.7 Plani mësimor i DATK i ndarë sipas krediteve në zbatim të udhëzimeve të VKM Nr.41, 21.01.2018, pdf;
Evidenca I.3 Aneks, Tabelat përmbledhëse, pdf;
Evidenca I.16, Vendimi nr.41 datë 24.01.2018, për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pdf., Shtojca nr.1, tabela nr.1, f.4.

| **Kriteri 2. Programi i** | Nga dokumentacioni dhe vizita në DATK mësuam se Programi | | | |

Leonleap



studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	i Studimit, jep mundësi dhe garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së Informacionit. Sipas bisedës me pedagogët puna për aftësimin teknologjik ka mbështetje nga studentët të cilët sot tërhiqen nga teknologjia. Mendojmë se është pranuar tashmë nga pedagogët, që teknologjia është në vetvete një urë drejt të nxënës, më shumë se një vend mbërritje, dhe që faktori kryesor për futjen e mjeteve të reja në të nxënës është përfshirja në të e një pedagogu të shkëlqyer. Katër lëndë në program ofrojnë mundësitë e metodologjinë e punës në terren dhe dokumentimin e fakteve përmes programeve Photoshop, Autocad, aplikimeve të GIS, dhe interpretimit të fakteve nëpërmjet Dronit. E veçanta është se në këtë Program zhvillohen edhe gjuhët klasike, greke e latine, atë të domosdoshme për arkeologjinë sidomos. Pa lënë mënjanë gjuhët e sotme moderne, anglisht, frëngjisht, Italisht, të domosdoshme për konsultimin me literaturën dhe komunikimin. Po kështu ky program në një kontekst më të gjerë i përgatit edhe në aspektin e njohjes së shkencave humane, sociale dhe sidomos komunikimit edhe atij dixhital. Këto lloje aftësish bëjnë të mundur formimin e gjerë dhe aplikimin në fushën e tyre të studimit, si vendosjen në një sfond historik të materialit arkeologjik apo kulturor, marketingun, reklamën etj. Këtë e kanë në programin e Studimit Bachelor. Dhe kanë njohuri mjaftueshëm. <i>Evidenca 1.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite_compressed pdf;</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga RVB dhe nga vizita në DATK mësuam se personeli akademik ndjek me përparësi përgatitjen e studentëve gjatë viteve të studimit, sidomos për aftësitë dhe kompetencat që fiton. Këto aftësi dhe kompetenca janë të paraqitura në programet lëndore. Në çdo orë mësimi pedagogët janë të vëmendshëm për të vënë në pah problemet kryesore të temës dhe sidomos kompetencat bazë të temës. Nisur nga këto objektiva ata i orientojnë studentët se ku duhet të përqendrohen, në detyrat gjatë vitit, punët praktike dhe veçanërisht në detyrimet përmbyllëse. Përpara provimeve dhe në fund sidomos zhvillojnë diskutime me studentët lidhur me ecurinë e lëndëve të veçanta, problemet e dala në leksione, seminare, praktika etj. Sugjerimet ju shërbenin për të rregulluar dhe përmirësuar problemet e dala gjatë diskutimit. Në këtë proces studentët ishin të lirshëm duke parë qasjen pozitive të pedagogëve. Pedagogët e DATK ishin të hapur me studentët dhe mjaft të komunikueshëm. Studentët e pohojnë këtë.

Leonez 

	<i>Evidenca I.20 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite_compressed pdf;</i> <i>Evidenca III.8 Raport analitik i pyetësorëve të realizuar nga DATK për Programin e Studimit Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë, viti akademik 2018-2019;</i> <i>Evidenca III.9 Raport analitik i pyetësorëve të realizuar nga DATK me studentët për programin Bachelor, viti 2021-2022, bazuar tek paketa e instrumenteve të Cilësisë, UT;</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Në kohën që jetojmë, sfida kryesore e arsimit është të mësuarit me kompetenca. Në këtë kontekst detyra e pedagogëve është që t'u japë mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e kompetencat e tyre. Edhe në lëndët teorike, por veçanërisht në orët e laboratoreve dhe praktikat profesionale studentët aftësohen për këto kompetenca. Gjatë takimit me stafin akademik u konstatua se ata kishin në qendër të punës së tyre studentin, dhe se qëllimi i arsimit është që të krijojë njerëz që janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, jo thjesht të përsërisin ato që kanë bërë brezat e tjerë-njerëz që janë krijuar, shpikës dhe zbulues; të cilët të jenë mendimtarë kritikë, që të mund të verifikojnë dhe jo të pranojnë çdo gjë që ju jepet. Personeli akademik pranë departamentit po bën përpjekje që studentët të përdornin krijimtarinë e tyre, që të ecnin përpara. Kjo në bazë të formimit akademik e njohurive që merrnin. Ky është një faktor shumë i rëndësishëm pasi i motivon studentët, shpreheshin ata. Po kështu stafi akademik ka qenë i interesuar për të vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të tjera kudo që ishte e mundur. Falë përpjekjeve anëtarë të departamentit kanë përfituar nga program Erasmus + në universitetin e Granadës dhe Pragë. Kanë qenë pjesëmarrës në shkollën verore të universitetit të Prishtinës etj. Gjithshka në shërbim të dijeve për t'i vënë në shërbim të studentëve. Veç pedagogëve edhe studentëve janë bërë pjesë e programit Erasmus, me një vit studimi në Evropë apo me semestra. Për të thelluar njohuritë e sidomos për të aftësuar në kompetenca DATK ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një sërë institucionesh jashtë institucionit, si: Laboratori i Fizikës Bërthamore, ai i Galerisë së Arteve etj. Pikërisht, duke vlerësuar ndikimin e mësimi aplikativ dhe konkret, punën e pavarur të studentëve, DATK aplikoi pranë AKSHI për ngritjen e laboratorit për të përsosur metodologjinë e punës me materialin arkeologjik. Laboratori ishte tejet modern dhe me standarte bashkëkohore. Sigurisht do të ndihmojë në aftësimin me kompetenca të studentëve. Edhe brënda auditorit pedagogët krijojnë një atmosferë diskutimi për problemet dhe të reja kërkimore shkencore. Vazhdimisht nxisin të nxënë të bashkëpunim. Kjo vetëm në funksion të

Leues



	cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies. Këto reflektoheshin në dokumentacion dhe dolën gjatë takimit me departamentin dhe studentët. <i>Evidenca III.16 Vendimi Nr.1, dt. 01.10.2021, për miratimin e Financimit të projekteve –Fituese të infrastrukturës së kërkimit Shkencor, për vitin 2021. Pdf;</i> <i>Evidenca III.17 Kontrata e AKKSHI –UT. Ngritja e laboratorit të analizave të materialeve dhe teknologjive në arkeologji dhe trashëgimi kulturore, pranë DATK, pdf;</i> <i>Evidenca III.27 Letër për pranim mobiliteti në universitetin e Granadës në Spanjë, E.Agolli, pdf;</i> <i>Evidenca III. 28 Letër për pranim mobiliteti në universitetin Charles, Pragë Çeki, Artan Puto, pdf;</i> <i>Evidenca III.29 Shkolla verore e universitetit të Prishtinës, E.Agolli, A.Canolli, pdf;</i> <i>Evidenca III.38 Dokumenti i mobilitetit të students Ana Paci, pdf;</i> <i>Evidenca I.58 Përmbajtja e programit syllabus Erasmus Plus dhe "Eneas Route", pdf;</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në DATK nga dokumentacioni mësuam se personeli akademik qoftë ky efektiv apo me kontratë bëjnë maksimumin për të dhënë të reja e fundit të shkencës së Arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore. Jo të gjitha mund të jenë në leksione. Këto zakonisht i kanë zhvilluar me organizma të huaja. Një ndër to është pjesëmarrja e studentëve në projektet e EUforCulture të Kombeve të Bashkuara, të cilët kanë zhvilluar leksione të hapura, por edhe pjesëtarë direkt në veprimtaritë për konservimin e materialeve të muzeut të Krujës e Kavajës. Në këtë veprimtari kanë qenë në bashkëpunim me Universitetin e Arteve të Bukura të Vjenës. Një mundësi e shkëlqyer për të shkëmbyer eksperiencë, për të vendosur kontakte, por edhe përfituar nga eksperiencia e tyre. Në këtë kontekst DATK është i hapur për marrëdhënie bashkëpunimi, mjafton të jetë në funksion të cilësisë së mësimdhënies. <i>Evidenca III.35 Studentët e DATK, pjesë e projektit EUforCulture të organizuara nga Kombet e Bashkuara, pdf;</i> <i>Evidenca I.28 Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për programin Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore;</i>
Konkluzione	<i>Që në hapjen e programit objektiv i tyre ka qenë përgatitja e specialistëve për Arkeologjinë dhe Trashëgiminë Kulturore. Gjithshka në funksion të cilësisë së përgatitjes së studentëve, që nga përcaktimi i lëndëve dhe përmbajtjes së tyre deri tek metodologjia e mësimdhënies. Në mënyrë shkencore u përcaktua rapoti midis lëndëve midis tyre dhe orët e kreditet për secilën lëndë. Në funksion të formimit akademik dhe</i>

Leone 

	<i>afësimit me kompetenca të studentëve u vendosën marrëdhënie me institucione jashtë departamentit. Për afësimin praktik u vendosën marrëdhënie bashkëpunimi me institucione jashtë departamentit si dhe ngritën një laborator modern për studimet metodologjike në arkeologji. Një vend i rëndësishëm i është kushtuar formimit të afësive dixhitale Mendojmë se është pranuar tashmë nga pedagogët, që teknologjia është në vetvete një urë drejt të nxënës, më shumë se një vend mbërritje, dhe që faktori kryesor për futjen e mjeteve të reja në të nxënës është përfshirja në të e një pedagogu të shkëlqyer</i> <u>GVJ sugjeron, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite me qëllim që të përputhet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Nga dokumentacioni dhe vizita në DATK u njohëm me rregulloren për mbylljen e studimeve në Bachelor. Institucioni ka përcaktuar kriteret për punimin e diplomës, ku kriteri kryesor është nota mesatare, gjithashtu edhe për provim formimi. Mesatarja për punim diplome ka një prag të caktuar dhe kjo bëhet me qëllim që të ketë punime sa më cilësore. Megjithatë nisur nga dëshira e disa studentëve për të bërë temë diploma edhe pse jashtë kriterit janë pranuar. Jo të gjithë studentët pa mesatare kërkojnë temë diplome. Kjo është arritur pas një diskutimi në departament dhe argumentit se edhe këta studentë që kërkojnë temë dilome, mund të stimulohen dhe të ndihmohen që të arrijnë objektivin e kërkuar. Ky tolerim është bërë me qëllim që studentëve t'u jepet mundësia të punojnë në mënyrë të pavarur. Mbase ndihmohen pak më shumë nga pedagogu udhëheqës, por ja kanë dalë. Departamenti dhe pedagogët kanë bërë një punë shumë të mirë në këtë drejtim. <i>Evidenca III.25 Udhëzues për punimin e Diplomës, DATK, në FHF.pdf;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë	Nga dokumentacioni dhe biseda në departament mësojmë se, DATK bërë një punë shumë të mirë në asistimin e studentëve për përgatitjen e provimit përfundimtar, qoftë ky provim

Lindes



studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	formimi apo temë diplome. Fillimisht i njohin studentët me rregulloren e funksionimit të provimit përfundimtar. Sqarime ju bëhet për formatin e fletës së provimit, fondin e pyetjeve të përgatitur nga lëndët kryesore, që kanë zhvilluar gjatë tre vjetëve të studimit. Grupi i temave të përzgjedhura, fondi i pyetjeve, ju vihet në dispozicion studentëve dy apo tre muaj para datës së provimit përfundimtar. Në fund i sqarojnë për organizimin e provimit, tezat, komisionin, mënyrën e korrigjimit etj. Korigjimi i provimit bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur nga përgjegjësi i departamentit. <i>Evidenca I.15, Rregullore e UT, Neni 59, 60, 61, 62, 63;</i> <i>Evidenca I.17, Rregullore e DATK, për organizimin e programit të ciklit të parë të studimit në Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor, pdf;</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Dokumentacioni i konsultuar tregon se komisioni i posaçëm për provimin ka përgjegjësinë kryesore për administrimin e procesit. Fillimisht përgatishin tezat me pyetje nga të tre vitet e studimit, sipas fondit të pyetjeve që përgatiten nga pedagogët e lëndëve. Komisioni bën kujdes, që të përfshijë në teza pyetje apo tema nga lëndët më të rëndësishme të programit. Teza përmban disa pyetje mbase 4 apo 5, sipas vendimit të komisionit. Dhe pasi vendosen studentët në sallë, një student tërheq në mënyrë rastësore një tezë. Një anëtar i komisionit lexon tezën dhe bën ndonjë sqarim për përmbajtjen e saj. Në fund bëhet vlerësimi me notë, pasi çdo pedagog ka bërë vlerësimin me pikë të pyetjes së korrigjuar. Dokumentacioni dhe biseda me pedagogët dhe studentët tregon se procesi bëhet mjaft korrekt dhe transparent. <i>Evidenca III.39 Model i tezave të provimit, pdf;</i> <i>Evidenca I.15, Rregullore e UT. Nenet nr.56 deri 67;</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi	Sipas dokumentacionit të ofruar dhe gjetjeve në Departament, konstatohet se pedagogët e kanë problem mbylljen e programit, madje përpiqen të nxisin dhe inkurajojnë studentët të përfshihen në punimin e temave të diplomave, pavarësisht notës mesatare. Pasi hartohet fondi i pyetjeve për provimin e formimit, bëhet shpjegimi nga pedagogët për përmbajtjen dhe orientohen se ku duhet të përqendrohen studentët gjatë përgatitjes. Fondi i temave dhe grup temave jepet rreth dy muaj para provimit. Gjithashtu ju tregohet edhe mëyra e zhvillimit të provimit e korrigjimit të provimit. Pjesë e informimit është edhe modeli i tezës dhe përmbajtja e saj. Në prag të provimit, ngrihet komisioni i posaçëm për zhvillimin dhe administrimin e provimit. Edhe për temat e diplomave ka procedure të përcaktuara qartë. Fillimisht studentët paraqesin në departament

Leoreq



është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	një kërkesë me shkrim në të cilën bëhet një draft paraprak për temën e menduar nga studenti, për të cilën do propozojë dhe pedagogun udhëheqës. Ky proces ndiqet nga koordinatori i programit të studimit në departament. Më pas nga departamenti sipas rregullores miratohet tema e paraqitur së bashku me pedagogun udhëheqës, i cili duhet të jetë i fushës ose i përafërt me të. Nga ky moment pedagogu fillon të udhëzojë studentin, hartojnë së bashku strukturën e temës dhe e ndjek në çdo hap të punës. Caktojnë ditë dhe orar për takimin e rradhës. E ndjek që nga përcaktimi i metodologjisë, studimin e literaturës dhe diskutimin e saj. Parashtrimin e gjetjeve, analizimin e tyre, diskutimin e rezultateve dhe konkluzionet. Gjithashtu e vlerëson edhe mënyrën e të shkruarit, paragrafët, kronologjinë, paraqitjen e hipotezave, lidhjen e paragrafëve etj. Në fund jep dakortësinë për ta paraqitur për mbrojtje ose jo. <i>Evidenca III.25 Udhëzues për punimin e Diplomës; Evidenca III 24 Listë e koleksionit të bibliotekës së DATK dhe lista e librave të pedagogëve që vihen në shërbim të studentëve për temat e diplomës;</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga dokumentacioni dhe biseda me pedagogët e studentët mësuam se në prag të provimeve të fundit, pedagogët bënin sqarimet e nevojshme për temat dhe grup temave të provimit përfundimtar, duke iu vënë në dispozicion edhe literaturën e rekomanduar. Veç kësaj ata i asistojnë, sidomos studentët e diplomave në kryerjen e matjeve apo punëve të tjera në terren që të arrijnë rezultatet e pritshme dhe të aftësojnë studentët në punën e pavarur dhe në procesin e analizës dhe interpretimit të fakteve apo analizave, sipas fushave të studimit. DATK kishte përvojë positive në këtë drejtim. Kjo edhe për faktin se ata ishin të lidhur me kërkimin, process mjaft i domosdoshëm për punimet e diplomave. Por edhe studentët në provim asistonin në këto procese gjatë praktikave mësimore. Pedagogët ishin të pranishëm dhe të gatshëm kurdoherë. <i>Evidenca I.15, Rregullore e UT, neni nr.59, 60, 61, 62, 63, 64; Evidenca 1.17, Rregullore e DATK, për organizimin e programit të ciklit të parë të studimit në Bachelor në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë, Neni 10. Pdf;</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Dokumentacioni dhe takimi në DATK tregojnë se pas përfundimit të provimit të formimit dhe mbrojtjes së temës diplomës studenti vlerësohet me notë. Në provimin e formimit, pasi korrigjohen pyetjet nga çdo anëtar i komisionit, vendosen pikët për çdo pyetje e më pas mblidhen pikët e përkëthehen në notë. Po kështu veprohet edhe me temën e diplomës, pasi student bën paraqitjen me PPT, i bëhen pyetje rreth temës,

Liviu

[Signature]

	mbahen shënime dhe në fund bëhet vlerësimi me notë. Notat i jepen studentëve nga kryetari i komisionit, si për provimin e formimit apo dhe për temat e diplomave më pas hidhen në Process Verbal, të cilin e dorëzojnë në sekretari për t'u hedhur në sistem elektronik të UT e arkivuar. Mbrojta e diplomave, provimit të formimit dhe vlerësimit të tyre bëhet tejet transparent dhe me korrektesë. <i>Evidenca I.15 Evidenca I.15, Rregullore e UT, Neni 58, 60; Evidenca III.40 Sistemi elektronik e-studenti në i UT. Pdf;</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas dokumentacionit dhe bisedës në DATK, në përfundim të studimeve, kur studenti ka plotësuar të gjitha detyrimet, d.m.th., ka plotësuar 180 kredite dhe nuk ka asnjë notë më pak se 5 (pesë), studenti pajiset me Diplomën dhe suplementin (listën e notave). Ky dokumentacion është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Edhe formati i diplomës dhe suplementit gjithashtu janë miratuar nga MAS. Në përfundim të studimeve gjithashtu studenti pajiset me të gjitha modalitetet e diplomës dhe të gjitha detajet e programit të studimit. Gjithashtu duhet të ketë në dispozicion edhe programin e lëndëve të studimit, me emër mbiemër të studentit, Institucioni, vitet akademike të studimit, me emrin dhe firmën e tutullarit të Institucionit. <i>Evidenca II.18 Suplementi i diplomës ofruar nga DATK; Evidenca III.41 Model Diplome i ciklit të parë të studimeve në DATK; Evidenca II.5 Rregullore e Sekretarisë mësimore e FHF. Pdf; Evidenca II.5 Rregullore e Sekretarisë mësimore e FHF, Neni 6, pika 23.pdf;</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në përfundim të procesit përmbyllës së studimeve, DATK, sipas rregullores ruan të gjithë dokumentacionin për një kohë të pacaktuar. Departamenti ruan në fondin e saj të gjithë provimet dhe temat e diplomave. Veç këtyre ruhen edhe të dhëna të tjera si, numri i matrikullimit, identifikimit, lëndët e shlyera në tre vjet, notat e marra në regjistërat, fizikë (print) themeltarë të sekretarisë, por edhe në mënyrë elektronike. Ky dokumentacion ruhet përgjithmonë në sekretari dhe është konfidencial. Ajo i jepet studentit kur e kërkon në çdo kohë që të paraqitet. Kjo u verifikua gjatë vizitës në sekretari. Sekretaria kishte të gjitha regjistrat dhe të plotësuar në mënyrë të rregullt. <i>Evidenca II.5, Rregullore e Sekretarisë FHF; Evidenca II.5, Rregullore e Sekretarisë FHF, Neni 6, pika 23;</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve</i>

Lesleez 

	përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Departamenti dhe pedagogët kanë detyra të përcaktuara për të asistuar mbylljen e përfundimit të studimeve. Bashkëpunimi student department dhe student pedagog udhëheqës është për t'u vlerësuar nga mënyra si kryhet. Kjo është edhe një arsye më shumë për mbarëvajtjen e procesit. Njësia kryesore dhe DATK kanë hartuar një rregullore transparente dhe funksionale. Kjo rregullore nuk le vënd për parregullsi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1				
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik me kohë të plotë shënon një prodhimtari të mirë kërkimore-shkencore, siç është dokumentuar në CV-të e tyre. Ka një përpjekje sistematike dhe kontribut në publikimin e artikujve në revista të indeksuara dhe të renditura në bazë të kriterëve shkencore akademike me faktor impakti. Ky angazhim për të përfshirë veprimtarinë kërkimore në forume prestigjioze ndërkombëtare thellon reputacionin shkencor të personelit akademik dhe do të rrisë përfaqësimin e institucionit. Është e rëndësishme të zhvillohet një strategji afatgjatë për përmirësimin e cilësisë së publikimeve shkencore, duke adresuar veçanërisht mundësitë për të kontribuar në mjedise të njohura dhe të pranura ndërkombëtare shkencore. Për sa i takon personelit akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi, për gjatë viteve akademike, të dhënat mbi kualifikimin shkencor janë si vijon:			
	Tituj/ grada	2021-2022	2022-2023	2023-2024

Handwritten signature and initials in blue ink.

	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	3	2	3	2	1
Prof. Asoc.	2	2	2	2	2	2
Dr./PhD.	3	10	3	10	3	8
Msc.	0	9	0	8	0	8
Totali	7	24	7	23	7	19

Vihet re që stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme mban minimumi gradën shkencore "Doktor", por pjesa më e madhe janë kategoria "Profesor" dhe "Prof. As.dr" si dhe "Msc" për specialistët.

Nga i gjithë dokumentacioni i ofruar, por edhe nga vizita e GJVJ në institucion me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit jemi bindur që lëndët mbulohe nga specialistët përkatës, duke ofruar një mësimdhënie cilësore dhe kompetente në auditore. Promovimi i stafit akademik është përditësuar me dokumentet përkatëse edhe nga Zyra e Burimeve Njerëzore, ku na u ofruan dosjet e secilit personel akademik.

Evidenca I.3. Aneks, Tabelat Përmbledhëse tab 6.1-6.3;
Evidenca I.30. CV të stafik akademik të programit të studimit;

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Për më tepër, struktura e programit të studimit është e përcaktuar me qartësi dhe transparencë, duke grupuar lëndët dhe modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe duke caktuar ngarkesën përkatëse në kredite. Ky organizim transparent i veprimtarive formuese shihet në planin mësimor të programit, siç vërtetohet nga Evidencat.

Planifikimi i programit të studimit përfshin një plan mësimor me informacion të detajuar lidhur me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve dhe moduleve, si dhe orët e caktuara për mësim në auditor dhe jashtë tij (*Evidenca I.16 vendim Nr. 41, datë 24.01.2018, për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, Shtojca Nr.1, Tabela Nr.1*) Si dhe *Evidenca IV.10, Udhëzim Nr.29, datë 10.09.2018 për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*. Pjesë e kësaj është bërë publike në faqen zyrtare të departamentit <https://www.fhf.edu.al/plani-mesimor->

Llorenz

[Signature]

	<u>arkeologji-dhe-trashegimi-kulturore/</u> .Ky nivel i transparencës dhe aksesit të informacionit ndihmon në kuptimin e plotë të strukturës dhe organizimit të programit nga studentët dhe personeli akademik, duke kontribuar në lehtësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit shtesë të përcjellë nga IAL, (Evidenca I.3 (korigjuar) Aneks, Tabela permbledhese) u konstatua se në të dhënat tabelore të paraqitura më herët, kishte lapsuse. Bazuar në të dhënat e përditësuara konstatohet se ngarkesa mësimore e personelit akademik për tre vite akademike është si më poshtë vijon: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2021-2022</td><td>3630</td><td>3180</td><td>450</td><td>87% /13%</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>3510</td><td>3075</td><td>435</td><td>87% /13%</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>2590</td><td>1870</td><td>720</td><td>73% / 27%</td></tr></table> Nga sa më sipër konstatohet se për 3 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, mbulohet mbi 70% nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. (Evidenca I.3 (korigjuar) Aneks, Tabela permbledhese)	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2021-2022	3630	3180	450	87% /13%	2022-2023	3510	3075	435	87% /13%	2023-2024	2590	1870	720	73% / 27%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2021-2022	3630	3180	450	87% /13%																	
2022-2023	3510	3075	435	87% /13%																	
2023-2024	2590	1870	720	73% / 27%																	
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Në përputhje me udhëzimet që ofron Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, institucioni dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit. Në bazë të dokumentave të paraqitura dhe takimeve të kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UT ka një eksperiencë shumë të mirë në punësimin e një stafi cilësor me dëshirë për t'u kualifikuar, dhe që demonstroi qëndrueshmëri në vite. Kontratat e punësimit janë të mirëpërcaktuara në detyrimet dhe të drejtat që lindin midis palëve, referuar ligjishtetë në fuqi sic dëshmohej edhe në Evidencën IV.3- Model i nënshkrimit të një kontrate të stafit të jashtëm akademik në programin Bachelor në DATK. Nga shqyrtimi i dosjes rezultoi se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është i njëjtë gjatë katër viteve.																				
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme	Procedura e rekrutimit të personelit zhvillohet në përputhje me legjishtetë e përshtatshme të UT. Për të siguruar një proces transparent dhe të drejtë, kriteret specifike përcaktohen me kujdes, dhe përpjekjet janë të ndërmarra gjatë gjithë procesit të																				

Llorenz

[Signature]

dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	rekrutimit për të gjetur një kandidat sa më afër nevojave të Departamentit. Ky i fundit ka të drejtën të hartojë dhe kriteret për rekrutimin e stafit akademik dhe të jetë udhëheqës në vendimarrjen lidhur me këtë proces. Gjatë tre viteve të fundit DATK nuk ka rekrutuar staf akademik efektiv, por në fillim të cdo viti akademik në bazë të nevojave që paraqiten, DATK publikon kriteret për staf akademik me kohë të pjesshme, sic vërtetohet nga <i>Evidenca I.15, Rregullore e UT-Neni 23</i>. Kriteret publikohen në faqen online të fakultetit në këtë adresë: https://ëëë.fhf.edu.al/category/njoftime/. Gjatë vizitës së GVI në institucion pamë nga afër të gjithë procedurën dhe respektimin e afateve për shpalljen e vakancave. Përzgjedhja e stafit bëhet në referencë të kriterëve të përcaktuara (<i>Evidenca IV.2 Praktika e rekrutimit të stafit të jashtëm akademik në DATK</i>) Prioritet i jepet nivelit të studimeve, përshtatjes së interesave shkencore të kandidatit me lëndën, përvojës akademike të mëparshme dhe punës shkencore, siç vërtetohet në <i>Evidencat I.12 Statuti i UT 2018-Neni 14, Departamenti, pika 5.k</i>.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të paraqitur nga GVB, por edhe nga vizita në institucion DATK disponon hapësira të posacme për të kryer punë laborator, duke përfshirë kompjutera me programet e nevojshme të dokumentimit dhe ilustrimit apo regjistrimit të të dhënave si: - Sistem i Fluoreshencës së Rrezatimit X; - Stereomikroskop; - Mikroskop me dritë të polarizuar; - Kamera dixhitale dhe soft i analizës së imazhit; - Mikroskop didaktik për studentët etj; Këto paisje ofrojnë një mundësi shumë të mirë për studentët në procesin e mësim, punimit të diplomave etj. (<i>Evidenca III.17. Kontrata e AKKSHI-UT. Ngritja e Labororit të analizave të materialeve dhe teknologjive në arkeologji dhe trashëgimi kulturore pranë DATK, paisjet e labororit</i>).
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të	Institucioni, përmes Sektorit të shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari-protokolli, si pjesë e Drejtorisë së shërbimeve ndihmës-akademike administrative (si strukturë përgjegjëse), mbledh, ruan dhe përditëson rregullisht të dhënat për çdo anëtar të personelit akademik që përfshihet në realizimin e programin të studimit, si dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit (<i>Evidenca VI.15</i>). Sektori i kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë, gjithashtu mbledh, ruan dhe

Leoneq

[Signature]

dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	përditëson rregullisht të dhënat mbi kërkimin shkencor të personalit akademik, pjesë e Departamentit (<i>Evidenca I.30</i>). Departamenti ruan dhe përditëson rregullisht (çdo vit akademik) dokumentet përkatëse si dhe (ngarkesën mësimore) për çdo semestër dhe vit akademik për secilin anëtar të personelit të përfshirë në programin e studimit, por gjithashtu DATK mbështet dhe inkurajon stafin akademik në të gjitha aktivitetet me karakter shkencor, marrëdhënie apo shkëmbimi eksperience (<i>Evidenca III.27</i>)
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Programi i studimit Bachelor në "Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë" përfshin zhvillimin e praktikës profesionale në planin e tij mësimor dhe është konceptuar si një program interdisiplinor studimi. Fakti që rekruton profile të gjera ekspertize nga arkeologjia prehistorike, klasike, historike, tek arkitektura, arkeometria apo praktikat dhe teoritë e restaurimit dhe konservimit, ka zhvilluar bashkëpunime me shumë institucione kërkimore-shkencore. Bashkëpunime me institucione të arsimit të lartë brenda ose jashtë UT, si Fakulteti Gjeologji-Miniera, Instituti i Fizikës Bërthamore, apo labororet e konservimit në Galerinë Kombëtare të Arteve. Bashkëpunim shumë i mirë me Institutin Arkeologjik, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturorë, Muzetë Kombëtarë dhe Rajonalë, AADF (<i>Evidenca I.54; I.55; I.56; I.44 dhe I.45</i>). Por një bashkëpunim shumë i mirë shihet me partnerët ndërkombëtarë, të cilët ofrojnë mundësinë e shkëmbimit të studentëve përmes projekteve të përbashkëta (<i>Evidenca IV.6; IV.7; IV.8; IV.9</i>) Përfshirje aktive të studentëve të DATK ka patur në një prej projekteve më të rëndësishme të zhvillimit strategjik të vendit sic ka qenë ai i Trans-Adriatik Pipeline (TAP) (<i>Evidenca I.50; I.51; I.53; I.45; I.54; I.55; I.56; I.57</i>)
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e	Veprimtaria e koordinorit të programit kryhet në përputhje me parashtrimet e Ligjit të Arsimit të Lartë, neni 25 i tij (<i>Evidenca Ligji 80/2015</i>). Nga vizita e GVJ në institucion na u komunikua që DATK ka caktuar një prej pedagogëve si koordinor të programit të studimit dhe kjo pasqyrohet edhe në RVB (<i>Evidenca II.3</i>)

Leoneq

[Signature]

vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	<i>Pas një vlerësimi të detajuar, mund të konkludojmë se personeli akademik tregon një prodhimtari të kënaqshme kërkimore-shkencore, të avancuar dhe publikon në revista prestigjioze ndërkombëtare. Programi i studimit shquhet për organizimin dhe transparencën, duke siguruar një mjedis efektiv mësimor. Procedurat e rekrutimit janë në përputhje me legjislacionin. Në të njëjtën kohë, detyrimet përfundimtare të programit Bachelor janë të përcaktuara qartë.</i> <i>GVJ konstaton se për 3 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, mbulohet mbi 70% nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Programi i studimit Bachelor në "Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor" zhvillohet në 2 auditorë leksionesh në godinën kryesore të FHF, duke përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara, përfshirë dhe standartet higjieno-sanitare (<i>Evidenca I.43</i>). në godinën Liria, DATK ka akses në përdorimin e Auditorit 210, me sipërfaqe 15m ² dhe kapacitet 90 studentë dhe disa salla seminaresh.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit	Departamenti disponon kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të mjaftueshme për të akomoduar studentët dhe personelin akademik. Mjediset mësimore që i shërbejnë këtij programi studimi, përfshirë auditorë leksionesh, seminare dhe laboratorë, janë të gjerë dhe plotësuese për nevojat e studentëve të këtij programi. Këto mjedise janë të pajisura me teknologji moderne, që sigurojnë realizimin e procesit mësimor, si në aspektin teorik ashtu edhe praktik. Laboratorët i ofrojnë çdo student një mundësi shumë të mirë të zotërimit të kompetencave profesionale (<i>Evidenca IV.5</i>)

Lleues'



të metodologjiave e teknologjiave bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Mjediset mësimore që shërbejnë për këtë program studimi, duke përfshirë auditorë leksionesh, seminare dhe laboratorë, janë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për të plotësuar kërkesat e moduleve, aftësitë teorike dhe praktike, si dhe objektivat formuese të programit të studimit në përgjithësi. Këto mjedise përfshijnë kompjuterë, projektorë, laptopë personal për çdo pedagog ofruar nga institucioni dhe pajisje të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e procesit mësimor. Në të njëjtën kohë, pajisja e auditorëve me lidhje WiFi (pa pagesë) në të gjitha mjediset e UT-së kontribuon në zhvillimin e mësimdhënies interaktive, duke përdorur metodologjitë e teknologjiave bashkëkohore. Pajisjet mbështetëse, si fotokopje, scan apo programet e kompjuterave si Autocad, Illustrator, Photoshop, ArcGIS janë në shërbim të lëndëve që aplikojnë njohuri praktike në DATK. Nga vizita e GJVJ në institucion konstatuam mbërritjen e laboratorit të analizave të materialit arkeologjik, për të cilin kërkohet një hapësirë se ku të vendoset. (<i>Evidenca III.16 dhe Evidenca III.17</i>)
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni siguron laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale. Gjithashtu DAKT ka vendosur marrëdhënie edhe me laboratorë të tjerë të UT, për të realizuar analiza të ndryshme në mbështetje të procesit mësimor apo kërkimit shkencor sic janë laboratorit i GIS pranë Departamentit të Gjeografisë në FHF, apo laboratorit në Institutin e Fizikës Bërthamore, Fakulteti i Gjeologji-Minierave, apo laboratorit në Galerinë Kombëtare të Arteve (<i>Evidenca III.17</i>)
Konkluzione	<i>Programi i studimit "Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor" zhvillohet në 2 godina të FHF dhe 2 salla në godinën Liria, të cilat janë vlerësuar si të mjaftueshme për nevojat e aktiviteteve mësimore. UT ka një gjendje shumë të mirë dhe përmesh kushtet e kërkuara, duke përfshirë standardet higjieno-sanitare dhe teknike. Departamenti ofron mjediset mësimore me kapacitet infrastrukturor dhe teknologji moderne për të akomoduar studentët dhe personelin akademik. Çdo orë e leksioneve apo e seminareve zhvillohet me projektor. Procesi mësimor mbështetet edhe me aksesore të tjerë ëhite-board, kompjutera, fotokopje, skanim, literaturë etj. Pajisjet janë nga aksesoret e gërmimit, mistri, pajisje pastrimi, deri tek mjetet</i>




	matëse, Teodolit, Total Station (TST), pajisje GIS, aparate fotografike etj.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Biblioteka e FHF dhe UT-se ofron një gamë të gjerë të literaturës multidisiplinare nga shumë fusha të studimit, duke përfshirë gjuhën, letërsinë, shkencat shoqërore, ekonominë, shkencat e natyrës, historinë, arkeologjinë, artin, dhe më shumë. Literatura e ofruar për studentët është bashkëkohore, në koherencë me zhvillimet më të fundit në fushën e arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore (<i>Evidenca II.6</i>) Me interes paraqitet fondi i DATK, i cili përmban literaturë specifike për studentët (<i>Evidenca III.24</i>)
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Biblioteka e institucionit ka ngritur një sistem të strukturuar të raportimit dhe monitorimit të cilësisë së fondit të saj, duke përfshirë atë fizik dhe online. Stafi akademik ka vënë në dispozicion të studentëve, qoftë për lëndët e detyrueshme, por edhe ato me zgjedhje në formatin print dhe pdf literaturën në gjuhën shqipe dhe të huaj. Për literaturë specifike të studimeve të arkeologjisë shqiptare studentët kanë akses burimin digital persee (<i>Evidenca III.23</i>)
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ofron dy biblioteka, Bibliotekën Nr. 1 (Bibliotekën e Institucionit) dhe Bibliotekën Nr. 2 (Bibliotekën e Departamentit), si burime të disponueshme për studentët e programit të studimit. Sipas tabelave përmbledhëse, <i>tabela 17</i> , studentët kanë të drejtë të anëtarësohen në këto biblioteka dhe të përdorin literaturën, si fizike ashtu edhe atë elektronike. Për këtë qëllim, secili student disponon një kartelë personale të përdoruesit, përmes së cilës mund të marrë dhe kthejë materialet e nevojshme. (Bazuar në Vizitën e GVJ në Institucion.)
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën	Bazuar në Vizitën e GVJ në institucion dhe <i>Evidencën 4.8.1</i> , Biblioteka e FHF dhe ajo e UT-së ofrojnë një gamë të gjerë literature me qasje multidisiplinare për studentët. Në funksion të studentëve gjatë vitit akademik 2020-21 ka qenë biblioteka online JSTOR në efikasitet të plotë, ku studentët futen me anë të adresës së tyre të e-mail dhe kanë akses në

Leoneq

shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	botimet më të fundit në fushën e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (<i>Evidenca II.13</i>).
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni ka ndërmarrë hapa për të siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në bibliotekat online që lidhen me fushën e programit të studimit, siç tregohet në <i>Evidencën III.23</i>. Të gjithë studentët kanë mundësi të përdorin librarinë dixhitale për nevojat e tyre studimore, siç është evidentuar gjatë Vizitës së GVJ në Institucion. Megjithatë, duhet theksuar se biblioteka nuk është e pajisur me aksesore dhe teknologji asistuese për studentët me aftësi të kufizuara. <i>GVJ sugjeron që në kuadrin e strategjisë për gjithë përfshirjen, të zhvillohet, buxhetohet dhe implementohet një plan për pajisjen e bibliotekës me teknologji asistuese, duke përfshirë aksesore dhe pajisje të tjera që mund të përmirësojnë përvojën e studentëve me paafësi ose aftësi të kufizuara. Kjo do të siguronte një mjedis të barabartë dhe të përshtatshëm për të gjithë studentët, duke adresuar nevojat specifike të përdoruesve me paafësi.</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga Vizita e GVJ në institucion u konstatua se biblioteka është e pajisur me disa kompjuterë të cilët ofrojnë studentëve mundësi të aksesojnë dhe përdorin kompjuterët për shkrimin e punimeve të tyre, duke shfrytëzuar njëkohësisht edhe burimet e literaturës online përmes motorëve të kërkimit. Ky vendim ofron një shërbim shtesë për studentët, duke i ndihmuar ata në përgatitjen e punimeve të tyre me përdorimin e burimeve të larmishme online.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ofron shërbim nga punonjësit e saj për studentët dhe personelin akademik gjatë ditëve të javës, nga e hëna deri të premten (me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit), në orarin 8:00—18:00 sipas <i>Evidencës II.6</i> . Kjo kohë përshtatet me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përballohet me numrin e studentëve dhe kapacitetin e saj. Orari është i afishuar në mjediset e institucionit dhe në hyrjen e Bibliotekës. Për çdo student, është e mundur të disponojë një kartelë personale të përdoruesit për të përdorur shërbimet e bibliotekës, siç konfirmon (<i>Evidenca 4.8.</i>)
Kriteri 8. Biblioteka dhe	Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit që ndjekin dhe

Luceq



njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	raportojnë mbi cilësinë e fondit fizik dhe online, duke përfshirë titujt kryesorë në shërbim të programit studimor. Përmbledhja përfshin aspektet e përditësimit, shkallën e shfrytëzimit nga personeli akademik dhe studentët, përdorimin e sallave të studimit, dhe përpjekjet për pasurim të fondit fizik dhe online.			
Konkluzione	<i>Biblioteka e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë është e pajisur me literaturë fizike qysh prej themelimit të saj në v. 1969, duke mbetur si fondi më i madh i literaturës së një institucioni të Arsimit të Lartë.</i> <i>Biblioteka pasurohet në mënyrë periodike me tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe është pjesë e sistemit të përbashkët bibliografik COBIS.NET (Evidenca I.37).</i> <i><u>Sugjerohet</u> që në kuadrin e strategjisë për gjithë përfshirjen, të zhvillohet, buxhetohet dhe implementohet një plan për pajisjen e bibliotekës me teknologji asistuese, duke përfshirë aksesore dhe pajisje të tjera që mund të përmirësojnë përvojën e studentëve me paafësi ose aftësi të kufizuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të	Bazuar në informacionin e prezantuar, organizimi administrativ në FHF ka një sekretari të veçantë për çdo njësi

Leoneq



menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	bazë apo program studimi (<i>Evidenca I.4</i>). Institucioni mban regjistra të rregullt me të dhëna specifike mbi regjistrimin e studentëve, numrat e matrikullimit, dhe informacione tjera, duke filluar nga dita e regjistrimit deri në diplomim. Ky proces i dokumentimit është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, siç përcakton Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nr. 9887, datë 10.03.2008, siç është evidentuar edhe nga Vizita në institucion (<i>Evidenca VI.15</i>). Në sekretari gjatë vizitës konstatuam nga afër me modele: - Regjistrin themeltar të studentëve; - Regjistrin e arritjeve akademike; - Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave; (<i>Evidenca V.6</i>)
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Bazuar në <i>Evidencat I.43 dhe VI.15</i> si dhe dosjet e personelit nga vizita e GVJ në institucion, dokumentacioni lidhur me aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, nga momenti i tyre i rekrutimit e deri në vazhdimësinë e angazhimeve, menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo drejtori kujdeset për administratën dhe arkivimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme. Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretarisë Protokoll në kuadër të kësaj drejtorie ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin e dokumentacionit.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Dosjet personale përmbajnë informacione të tilla si kontratat e punës, diplomat dhe tituj akademikë, CV-të dhe të dhëna të tjera relevante për arritjet akademiko-shkencore të personelit. Kjo përfshin një përjasje efikase dhe të rregullt të dokumentacionit që lidhet me profilin dhe kontributin e secilit anëtar të personelit në institucion. Bazuar në informacionin e ofruar nga vizita e GVJ në institucion, i gjithë dokumentacioni i institucionit është i qasshëm nga personeli akademik dhe studentët në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Te interesuarit që dëshirojnë të marrin informacionin e nevojshëm duhet të drejtohen tek zyra përkatëse për këtë qëllim.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe	Personeli akademik dhe studentët të FHF përdorin përveç faqes zyrtare dhe postës elektronike edhe disa platforma elektronike të tjera. Këto përfshijnë Microsoft Office 365, Microsoft Teams, dhe platforma të tjera. Në faqen zyrtare të institucionit

Leedeeq



shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	https://www.fhf.edu.al/studentet/ përmbahen informacione rreth përdorimit të platformave të tilla si Office 365 dhe Teams për mësimin online si dhe sistemin e-student. Kjo tregon se institucioni ka integruar mjete dhe resurse moderne teknologjike për të mundësuar mësimin online, bashkëpunimin, dhe komunikimin efikas midis personelit akademik dhe studentëve.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Platformat elektronike sigurojnë një monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Sipas nevojave, këto sisteme ofrojnë mundësi për raportime individuale në lidhje me përparimin akademik të studentëve dhe afatet e vendosjes së vlerësimeve nga personeli akademik. Referuar <i>Evidencës IV.14</i> , në faqen e UT publikohen jo vetëm të dhënat për aktivitetet e fakultetit por gjithashtu edhe të dhëna mbi njoftimet për datat e provimeve, bursat, thirrjet e hapura për mundësi mobiliteti, thirrjen për hapjen e regjistrimeve në programe të ndryshme studime, orari, apo njoftime të ndryshme.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Njësia bazë e UT-së ka një faqe interneti dhe një faqe në Facebook për të informuar studentët, ish-studentët dhe komunitetin për veprimtarinë e saj. Informacioni i publikuar në faqen zyrtare të UT-së dhe Departamentit përfshin detaje rreth programit të studimit, misionit, planit mësimor, strukturës mësimore, orarit, dhe kalendari i provimeve. Gjithashtu, shpallet informacion mbi Njësinë Bazë, personelin akademik, dhe aktivitete të ndryshme në gjuhën shqipe dhe angleze. (<i>Evidenca IV.14</i>)			
Konkluzione	<i>Institucioni administron dhe menaxhon të dhënat që i referohen këtij program studimi nëpërmjet një sitsemi efikas të menaxhimit. Ky sistem mundëson administrimin dhe monitorimin në kohë reale të informacionit në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor në këtë program studimi.</i> <i>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platformat Microsoft Office 365, Microsoft Teams për shkëmbimin e informacionit midis personelit akademik dhe studentëve si mënyra më e mirë për ritjen e aksesit në informacion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të

L. L. L.

[Signature]

studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në informacionin e prezantuar, UT zhvillon një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbajtjen e programeve të studimit. Hartimi i këtij raporti ndodh në përputhje me Statutin e UT dhe modelin e buxhetit të shtetit, të caktuar nga udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (<i>Evidenca IV.19 dhe IV.20</i>) Administratori i UT harton projektin e buxhetit vjetor, duke u bazuar në propozimet e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë, të mbështetura në Planin Strategjik të zhvillimit të UT-së dhe Planin buxhetor afatmesëm. Ky projekt buxheti miratohet nga Bordi i Administrimit, me propozim të Senatit Akademik. (<i>Evidenca I.12 dhe I.14</i>)
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Ky proces është pjesë e strukturave qendrore të menaxhimit financiar të Ut-së dhe njësive bazë. Këto struktura kontribuojnë përmes propozimeve dhe kërkesave për veprimtari, projekte, botime, pjesëmarrje në kongrese, pasurim të bibliotekës, abonime, dhe aktivitete të tjera që nuk janë pjesë e drejtpërdrejtë e mbulimit financiar të procesit akademik në auditor. Propozimet dhe kërkesat e tyre dërgohen në përputhje me përcaktimet ligjore, nevojat, dhe planet strategjike të zhvillimit të institucionit. Miratimi i kërkesave përcaktohet në buxhetin e finalizuar, duke pasqyruar nevojat dhe interesat e institucionit. (<i>Evidenca IV.21, IV.22 VKM 75, datë 12.02.2018 dhe Evidenca IV.23</i>)
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij në mënyrë periodike. Drejtoria e Shërbimeve Universitare harton dhe paraqet Raportin Financiar Vjetor, duke përmbledhur të ardhurat dhe shpenzimet sipas kërkesave ligjore në fuqi. Ky raport ofron një pasqyrë të detajuar të situatës financiare të institucionit. Përmasat financiare të UT janë nën vëzhgimin e institucioneve përgjegjëse, duke përfshirë Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe

Handwritten signatures and initials.

	MAS (Ministria e Arsimit dhe Sportit), të cilat kryejnë audit financiar periodik për të siguruar transparentë dhe rregullsi në administratën e financave publike. Edhe audit i brendshëm i cili është në varësi të Bordit të Administrimit, funksionon në bazë të ligjit të arsimit të lartë (Evidenca I.12 Statuti i UT 2018-Neni 57, Njësia e Auditimit të Brendshëm)			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe Administratori paraqesin raporte periodike në Senatin dhe Bordin e Administrimit, raportuar për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraprak. Ky proces siguron një transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin financiar, duke siguruar që organet vendimmarrëse të institucionit të kenë një vështrim të qartë mbi shpenzimet dhe të ardhurat aktuale.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti i Tiranës sigurohet financiarisht nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat dytësore nga studentët, duke përfshirë tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet e tjera ofruara ndaj të tretave. Analiza financiare vjetore e institucionit fokusohet në menaxhimin e efikas të këtyre burimeve për të garantuar një qëndrueshmëri financiare. Për këtë qëllim, vlerësohet realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare dhe të gjitha aspekteve të financimit dhe shpenzimeve, duke siguruar që fondeve të disponueshme t'u jepet një përdorim të përshtatshëm. (Evidenca III.16, III.17)			
Konkluzione	Bazuar në informacionin paraqitur, UT ndjek një procedurë transparente për hartimin dhe zbatimin e buxhetit. Administratori i UT harton projektin e buxhetit vjetor, duke përfshirë propozimet e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Baze, në përputhje me Planin Strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky projekt miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik. Gjithashtu, raportimi financiar i UT përfshin një analizë të kostove dhe mbështetjes financiare për programet e studimit, duke u fokusuar në një qëndrueshmëri financiare. Strukturat e menaxhimit financiar, prezantojnë propozime dhe kërkesa për veprimtari dhe projekte që kontribuojnë në pasurimin e institucionit. .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Pranimi i studentëve të rinj dhe procesi i tyre akademik në kuadër të ciklit të plotë në DATK është ndërtuar mbi një politikë të qartë, e hartuar dhe zbatuar me respekt për kornizën ligjore aktuale dhe rregullat vendore të institucionit. Kjo politikë dhe dispozitat korrespondojnë me Statutin dhe rregulloren e UT, siç paraqitet në <i>Evidencën I.4</i> . Procesi fillon me përcaktimin e kuotave dhe kriterëve nga Njësitë Bazë, duke u nisur me një vendim të Senatit Akademik një vit para fillimit të vitit akademik të ardhshëm, duke respektuar kriteret e institucionit dhe duke u bazuar në nevojat dhe karakteristikat e veta, përcakton kuotat dhe kriteret e veta identifikuese, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të UT. (<i>Evidencat V.1, II.8, II.10, I.12, V.2, II.5</i>)
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat dhe dispozitat ligjore të UT-së dhe për trajtimin e studentëve, nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve, kanë si synim sigurimin e barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit në programin e studimit. Ky angazhim përbën dokumentacionin aktual, praktikën aktuale, dhe përvojën afatshkurtër dhe afatgjatë. Rregullorja e Studimeve në UT (<i>Evidenca I.15</i>), së bashku me dokumentacionin analog të njësisë tjera, detajojnë me kujdes procedurat dhe praktikën për trajtimin e studentëve, duke siguruar transparencë dhe trajtim të drejtë për të gjithë (<i>Evidenca I.17</i>)
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në	Institucioni aplikon një proces transparent për pranimin e studentëve, duke publikuar kriteret dhe kuotat në faqen zyrtare para fillimit të vitit akademik. Këto kriteret janë në përputhje me VKM-të aktuale dhe aprovohen nga Dekanati dhe Senati Akademik. Strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve të ardhshëm, duke përfshirë Sektorin e Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Studentore, organizojnë ditë të hapura për maturantët për t'u njohur me ofertat e universitetit. Në përpjekje për tërheqjen e studentëve në vitin e parë, UT dhe

Leoneq 

zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	DATK ndjek praktika të ndryshme, përfshirë bashkëpunimin me shkollat e mesme dhe kontaktet e drejtpërdrejta me potencialet e studentëve. (Evidenca IV.16, I.17, I.13)
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	UT ka implementuar mekanizma efikase për të përcjellë informacionin lidhur me kriteret, procedurat e pranimit, transferimin e studimeve dhe diplomimin në faqen zyrtare https://ëëë.fhf.edu.al/studentet/ . Kjo përfshin publikime të dokumenteve rregullative dhe lajme të aktualitetit, duke përdorur Sistemin Digjital të Sekretarisë Mësimore. Për të siguruar një akses të lehtë dhe të drejtpërdrejtë, sekretaritë mësimore në nivel institucional dhe fakulteteve, së bashku me zyrat e Alumni, Këshillin e Karrierës dhe Vlerësimin e Vazhduar, ofrojnë një burim konkret të informacionit. Për kandidatët e mundshëm, UT komunikon paraprakisht programet e studimit në portalin e maturës shtetërore, duke përfshirë kriteret e pranimit për secilin program. Ky shërbim ofron një gamë të diferencuar të informacionit, duke përfshirë edhe udhëzues studimesh, albume dhe spote publicitare. (Evidenca I.23 dhe I.24)
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UT dhe DATK ndjek një praktikë të zakonshme në publikimin e kriterëve dhe kërkesave për programet e studimit para fillimit të vitit akademik. Kjo përfshin një gamë të gjerë të mjeteve komunikuese, duke filluar nga faqja zyrtare e UT-së dhe përfunduar me kontakte direkte me individë dhe grupe të interesuar. Zyra e Alumni dhe Këshilli i Karrierës, në bashkëpunim me fakultetet dhe njësitë bazë, janë përgjegjëse për publikimin e informacioneve në faqen zyrtare të UT-së, rrjete sociale, media lokale, fletëpalosje, dhe postera, duke siguruar një informacion të plotë rreth programeve të studimit, diplomave, dhe mundësive të punësimit, përfshirë kriteret e veçanta për ndjekjen e tyre përmes organizimit të ditëve të informimit në gjimnaze etj. (Evidenca IV.16, V.5, IV.15).
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UT-ja, në përputhje me legjislacionin aktual, publikon çdo vit kriteret shtesë për përzgjedhjen e kandidateve me aftësi të veçanta dhe për përfshirjen e shtresave të marginalizuara, duke parashikuar vendet e tyre në kuotat vjetore pritëse (Evidenca II.10, I.12). Përfshin masat infrastrukturore dhe mbështetjen për aksesin e tyre. UT ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të mbështetur këto kategori në përballimin e sfidave (Evidenca V.2).
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon	Institucioni, në përputhje me rregulloren e programit të studimit, përgatit dhe publikon çdo vit kriteret për përzgjedhjen




përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	e studentëve nga shtete të tjera, duke përfshirë këtu dhe kriteret specifike të caktuara për secilin vit akademik. Për studentët nga këto shtete, ofrohet mundësia e konvertimit të diplomave dhe ekuivalentimit të lëndëve, sipas dispozitave të Statutit të institucionit. (Evidenca II.8, II.10, V.2, II.5, IV.14, IV.16)			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni, në përputhje me legjislacionin aktual, harton politika për bursa dhe ofron mbështetje financiare për shtresat në nevojë. Ky angazhim përfshin uljen e tarifës së studimit, rritjen e cilësisë së pranimin në programe prioritare, dhe kontributin në zhvillimin ekonomik të vendit. (Evidenca V.4, IV.20)			
Konkluzione	UT implementon një politikë të qartë dhe transparente për pranimin dhe zhvillimin akademik të studentëve, të bazuar në legjislacionin vendas dhe Statutin e institucionit. Politikat dhe dispozitat për trajtimin e studentëve janë në përputhje me ligjin dhe promovojnë barazi dhe drejtësi. Statuti dhe Rregullorja e Studimeve në UT rregullojnë trajtimin e studentëve dhe sigurojnë informacion të aksesueshëm për kandidatët nëpërmjet Mjeteve të Komunikimit Publik dhe portalit U-Albania. Institucioni gjithashtu zbaton mekanizma efikase për publikimin e informacioneve në faqen zyrtare, duke përdorur një gamë të gjerë të mjeteve komunikuese dhe bashkëpunimin me strukturat kompetente, duke treguar kujdes të vecantë lidhur me promovimin dhe ofrimin e informacioneve të duhura për aspirantët student në programet e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit	Rregullorja institucionale dhe programet e studimit ofrojnë informacion për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve (Evidenca II.5). Në fillim të vitit akademik, studentët marrin informacion në lidhje me procesin mësimor dhe orarin e mësimave në faqen zyrtare https://ëëë.fhf.edu.al/studentet/ Syllabus-i përmban detaje mbi vlerësimin e dijeve dhe aftësive

Lidhja



akademik në tjetrin.	të studentëve, prezantuar në fillim të çdo periudhe shkollimi për të bërë të qartë sfidat dhe kërkesat e vitit akademik (<i>Evidenca I.20</i>)
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UT ofron informacion rreth kriterëve dhe procedurave të njohjes së kualifikimeve të mëparshme, transferimit të kredive dhe njohjes midis programeve studimore, duke ndjekur rregulloret dhe statutin e institucionit (<i>Evidenca I.16, V.6, Evidenca I.3. Aneks Tabela Përmbledhëse, Tabela 21</i>). Këto informacione janë të aksesueshme për studentët në fillim të vitit akademik në brendësi të UT dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë. Detaje të plota dhe dokumentacion i nevojshëm mund të gjenden pranë sekretarisë mësimore dhe në njoftimet e shpallura në stendat informative të UT (<i>Evidenca I.17</i>).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, në bazë të Rregulloreve institucionale dhe <i>Evidencave I.16</i> , informon studentët në fillim dhe gjatë vitit akademik rreth kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të dijeve për çdo lëndë dhe program studimi. Ky informacion përfshin sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, kontrollin e dijeve, kushtet për hyrjen në provim, organizimin e provimeve, komisionet e provimeve, zhvillimin e provimeve, shpalljen e rezultateve, ankimimin dhe mundësitë për përmirësim të notave (<i>Evidencat I.16 dhe I.20</i>).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studentët në programin e studimit Bachelor në "Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore" mund të diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Njësia Bazë i inkurajon studentët të angazhohen në kryerjen e punimeve të diplomës qysh në fillim të programit të studimeve, duke ndarë informacione të detajuara rreth formatit të temës, rregullat e citimeve, strukturën që u vihet në dispozicion studentëve (<i>Evidenca III.25</i>)
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Para fillimit të çdo viti akademik dhe periodikisht, UT organizon takime të hapura dhe publikon udhëzues të posaçëm për informimin e maturantëve dhe të interesuarve mbi programet e studimit në UT (<i>Evidenca IV.17</i>). Njësia Bazë informon përmes takimeve maturantët lidhur me aktivitetet e tij në formë interaktive (<i>Evidenca I.50</i>) apo dhe përmes aktiviteteve që marrin vëmendje publike, sic është edhe rasti i pjesëmarrjes aktive të studentëve në projektin zhvillimor TAP (<i>Evidenca I.50, V.9, V.10, V.11</i>)
Konkluzione	UT ofron informacion të detajuar për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve, nëpërmjet faqes zyrtare, syllabuset e lëndëve etj.




	<i>UT gjithashtu ofron informacion për njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe transferimin e krediteve. DATK informon rregullisht studentët për procedurat e vlerësimit të dijeve. Studentët në programin e studimit Bachelor në "Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë" mund të diplomohen me provim përfundimtar ose punim diplome, dhe procedurat janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në detaje për strukturën, organizimin, dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes Rregullores së Studimeve në UT, Rregullores së UT-së, si dhe Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në "Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë", dhe përmes udhërrëfyesit për studentin. Ky informacion është i qasshëm elektronikisht edhe në faqen zyrtare të UT-së. Gjithashtu, në fillim të çdo viti akademik, organizohen takime informuese me studentët e vitit të parë të studimeve. (Evidenca I.29, IV.15, I.41)
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të çdo viti akademik dhe në vijim, DATK ofron studentëve të programit të studimit Bachelor në "Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë" çdo informacion, udhëzim dhe rregullore që i siguron studentit personalitet dhe autoritet, duke përfshirë njohjen e plotë me programin, planin mësimor, lëndët dhe përmbajtjen e tyre, si dhe gjithë veprimtaritë formuese në ciklin e studimeve. Rol kryesor në këtë proces luan dhe koordinatori i programit të studimit. Gjatë kësaj jave studentët njihen me rreftulloren e DATK. Sipas një orari të caktuar për secilën lëndë të semestrit të parë pedagogët bëjnë prezantime të shkurtra ku studentët sqarohen lidhur me përmbajtjen, kërkesat dhe mënyrën e zhvillimit të lëndës. (Evidenca I.29, IV15, I.41)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Alumni dhe Këshillimi i Karrierës në UT, ndihmon studentët të gjejnë mundësi të punësimit. Vetë DATK e ka mision orientimin e studentëve me mundësitë që ofron tregu i punës në profilet e tyre të studimit. Studentët përmes praktikave mësimore apo intershipëve janë anëtarë të grupeve të punës në projekte të Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të tjera vartëse. (Evidenca I.46, I.53, I.55, I.56, I.44, I.45, I.46, I.47).

Leones

[Signature]

	Studentët e DATK kanë prioritet edhe projektet e restaurim-konservimit të realizuara nga organizata Trashëgimia Kulturore pa Kufinj dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit. (Evidenca I.44, V.12, I.60, I.22)			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Njësia Bazë ofron te studentët informacion të plotë dhe të përditësuar lidhur me strukturën mësimore, planin mësimor, orarin e mësimave, kalendarët e provimeve, dhe njoftimet përmes disa kanaleve, duke përfshirë standën e Informimit pranë Njesisë Bazë, sekretarinë mësimore, faqen zyrtare të internetit, postën elektronike personale dhe rrjetet sociale.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni për programin e studimit është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë për studentët përmes disa kanaleve, duke përfshirë faqen zyrtare të internetit të UT, postën zyrtare elektronike dhe sistemin e sekretarisë mësimore. Njësia Bazë gjithashtu operon një faqe Facebook me menaxhim të brendshëm, duke përdorur këtë platformë për koordinim dhe bashkëveprim në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe aktiviteteve akademike. Faqja Facebook mund të gjendet në https://ëëë.facebook.com/share/12BgbQHjYa9/?mibextid=ëëXIf			
Konkluzione	Studentët informohen përmes rregulloreve të institucionit dhe programit, duke përfshirë njohjen me lëndët, planin mësimor dhe aktivitetet formuese. DATK ofron informacion të plotë për studentët e programit të studimit Bachelor në "Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore", përfshirë programin dhe planin mësimor. Zyra e Alumni dhe Këshillimi i Karrierës në UT kontribuojnë në gjetjen e mundësive të punësimit. Njësia Bazë siguron informacion lidhur me strukturën mësimore dhe njoftimet përmes kanaleve të ndryshme. Informacioni për programin e studimit është lehtësisht i arritshëm për studentët në distancë përmes faqes zyrtare, postës elektronike dhe sistemit të sekretarisë mësimore. Edhe nga vizita e GVJ në takimin me studentët na rezultoi se pjesa më e madhe kishin shumë informacion për programin e studimit, një pjesë të sugjeruar nga përvojat pozitive të shokëve e familjarëve të tyre për mundësitë e shumta në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Leoluej 

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mësimore e FHF bashkë me DATK mbajnë të dhëna sistematike vjetore lidhur me numrin e studentëve të diplomuar në cdo program studimi. Edhe nga vizita në institucion i GVJ u bë e mundur ofrimi i të gjithë dokumentacionit lidhur me numrin e studentwvw aktualw, atyre tw diplomuar. (Evidenca I.12, I.16, I.3. Aneks Tabela Përmbledhëse, Tabela 21)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	UT ka në dispozicion statistika vjetore të detajuara për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, duke përfshirë tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, dhe diplomimin e tyre. Të dhëna mbahen edhe për studentët që crregjistrohen nga programi. Kështu gjatë 8 viteve nga DATK janë crregjistruar 15 studentë. (Evidenca I.4, V.6) Në kuadrin e kompetencave të saj, Sekretaria Mësimore administron dokumentacionin me të dhënat e studentëve që ndjekin këtë program studimi. Referuar shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vite akademike është si më poshtë vijon: Viti akademik 2021 – 2022 65 studentë; Viti akademik 2022 – 2023 23 studentë; Viti akademik 2023 – 2024 12 studentë;
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Përmes Sekretarisë Mësimore dhe sistemit elektronik e-student, UT menaxhon të dhënat statistikore të studentëve, duke përdorur një kombinim të metodave manuale dhe elektronike. Ky proces siguron sigurinë dhe zbatimin e rregullave ligjore. Të dhënat e statistikave janë lehtësisht të gjatshme për personat e autorizuar (Evidenca III.40)
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton	Njësitë përbërëse të UT kryejnë veprimtarinë e tyre në pajtueshmëri me aktet. Përmes kontrollit periodik, UT vlerëson dokumentacionin në Njësitë bazë, kryesore dhe Sekretarive mësimore, duke dokumentuar situatën dhe siguruar saktësinë e informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre. Sistemi i të dhënave statistikore ruhet dhe menaxhohet nga Drejtoria e Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave në UT (Evidenca III.21) Gjatë vizitës së GVJ në institucion konstatuam nga afër pranë sekretarisë pajisjen e studentëve me numër matrikullimi unik

Leolee



gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	me anë të të cilit identifikohet edhe në sistem si dhe cdo të dhënë tjetër që kishte të bënte me lëvizjet e studentit. (Evidenca III.20)			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë kulturore harton raporte periodike mbi profiling e studentëve të saj. Ka si strategji dhe e zbaton atë edhe në shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. Kontaktet sistematike me grupet ALUMNI (Evidenca I.60) rezulton që studentët që kanë përfunduar edhe nivelin e dytë të studimeve të jenë angazhuar pranë instiucioneve që ofrojnë mundësi punësimi. (Evidenca I.22)			
Konkluzione	UT, në bashkëpunim me specialistin e Statistikës në FHF, siguron statistika vjetore për programin e studimit Bachelor në "Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore". Menaxhimi i këtyre të dhënave zhvillohet përmes Sekretarisë Mësimore dhe sistemit elektronik e-student, duke garantuar zbatimin e rregullave ligjore. DATK, në kuadër të veprimtarisë së saj, analizon të dhëna mbi profilin, cilësinë dhe punësimin e studentëve, duke hartuar raporte dhe strategji përmirësimi. Këto raporte integrohen në dokumentacionin më të gjerë të FHF dhe UT-së, duke përfshirë raportet e Fakulteteve, Sekretarive Mësimore, Zyrës së Alumni etj. Ky proces monitoron dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve të ofruara nga UT, duke prezantuar rezultatet në raporte periodike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve	Referuar Statutit të UT (Evidenca I.12) në përmbajtjen e tij parashikon të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar në: - Senatin Akademik;

Leoneq 

dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	- Këshillin e Etikës; - Komisionet e përhershme; - Këshillat Studentorë; Po kështu edhe kuadri ligjor për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në vendin tonë përcakton në një nen të vecantë të drejtën e studentëve për tu organizuar në Këshilla Studentorë, si organizime të pavarura që përfaqësojnë interesat e tyre. <i>(Evidenca Ligji Nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 59, Këshillat e Studentëve)</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bazuar në Statutin e tij, UT siguron përfshirjen e studentëve në procese vendimmarrëse dhe vlerësuese mbi aspektet akademike dhe administratë. Përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik shprehin mendime dhe propozime për çështje të përgjithshme akademike. Studentët organizohen në Këshillat Studentore dhe janë pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit. Ata janë pjesë e Këshillit të Etikës dhe marrin pjesë aktivisht në sondazhe vjetore të studentëve. Pëfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit u mundëson atyre të përfaqësojnë qëndrimin e studentëve mbi procesin akademik dhe jetën universitare. Studentët e shprehin qëndrimin dhe vlerësimin e tyre edhe nëpërmjet pyetësorëve të cilët realizohen në mënyrë sistematike dhe vlerësojnë aspekte të procesit të mësimdhënies, infrastrukturës dhe administrimit të programit mësimor. <i>(Evidenca V.15 dhe V.16)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	UT, në përputhje me Statutin dhe aktet rregulluese, janë sanksionuar të drejtat e studentëve ku të shprehin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e personelit akademik. Studentët kanë të drejtë të shprehen në lidhje me çështje të ndryshme, duke përfshirë planet dhe programet e studimeve, cilësinë e shërbimeve, tarifat, dhe kontribute financiare. DATK vlerëson kontributin e studentëve si pjesë e procesit akreditues, duke reflektuar propozimet e tyre dhe duke u mbështetur në bashkëbisedime të lira. Anketat vjetore të studentëve përbëjnë burim të rëndësishëm për vlerësimin e performancës së institucionit dhe përmirësimin e programit të studimit <i>(Evidenca I.16)</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe	Procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, duke përfshirë ankimin e rezultateve nga studentët, është përcaktuar në të gjitha Rregulloret institucionale. <i>(Evidenca I.15)</i>



ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Gjatë vizitës së GVJ në institucion, studentët ishin shumë të kënaqur me transparencën e treguar nga pedagogët për mënyrën e vlerësimit të tyre. Cdo vlerësim bëhej me pikët përkatëse, komentet dhe në rast të ndonjë pakënaqësie, studentët kanë të drejtën të ankimojnë notën. (Evidenca I.15)			
Konkluzione	<i>UT garanton të drejtën e studentëve për të marrë pjesë në proceset vendimarrëse të Universitetit nëpërmjet përfaqësimit në organet më të rëndësishme në nivel institucional.</i> <i>Pëfshirja e studentëve në organet vendimarrëse të institucionit u mundëson atyre të përfaqësojnë qëndrimin e studentëve mbi procesin akademik dhe jetën universitare.</i> <i>Studentët e shprehin qëndrimin dhe vlerësimin e tyre edhe nëpërmjet pyetësorëve të cilët realizohen në mënyrë sistematike dhe vlerësojnë aspekte të procesit të mësimdhënies, infrastrukturës dhe administrimit të programit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Referuar RVB studentët në këtë program studimi, por edhe në rang Fakulteti informohen dhe asistohen nga koordinatori i departamentit lidhur me problematika apo orientime të programit të studimit. Koordinatori gjithashtu njofton thirrje të mobiliteteve për studentët. Gjatë vizitës së GVJ në institucion dhe takimit me Dekanin dhe Drejtuesen e Departamentit na u komunikua që FHF ka një Zv/Dekan në strukturë me rol parësor në marrëdhëniet me studentët, organizimet, këshillimet, mobilitetet, veprimtaritë kulturore sportive etj. (Evidenca V.17) Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon cdo vit javën e Këshillimit të Karrierës, por risi në UT dhe në FHF vecanti është organizimi i panairit të punës, i cili u ofron mundësi të shkëlqyera studentëve për tu integruar në tregun e punës sipas specialiteteve dhe prirjeve që shfaqin në përputhje me ofertat e

	kompanive të ndryshme. (Evidenca I.23 dhe I.24)
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Studentët informohen, këshillohen, ndiqen dhe informohen nëpërmjet disa burimeve në UT. Njësia bazë, përgjegjësit, titullarët e lëndëve dhe stenda e Informimit ofrojnë shërbime në këtë drejtim. Sekretaria Mësimore e Fakultetit, Sektori i Standardeve dhe Kurrikulave, si dhe Zyrat e Alumni dhe Këshillimit të Karrierës janë gjithashtu burime kyçe për mbështetjen dhe ndjekjen e studentëve në çështjet mësimore. Nga vizita e GVJ në institucion, por edhe nga dokumentacioni i paraqitur konstatuam që pranë UT është ngritur Komisioni për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët (Evidenca V.19) duke ndërtuar marrëdhënie të ngushta me studentët, tutorët si dhe njësitë e brendshme. Ky komision përbëhet nga 7 anëtarë, 4 pedagogë dhe 3 studentë. (Evidenca V.19)
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët. Ata sigurojnë informacion dhe këshilla për çështjet mësimore, programet e studimeve dhe diplomimin. Gjithashtu, ndihmojnë studentët që kanë përfunduar studimet në nivelin e parë për të gjetur mundësi për vazhdim të studimeve ose për punësim. Kjo zyrë bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin e praktikave profesionale, duke ofruar trajnime dhe shërbime të tjera të përmirësuara për zhvillimin e studentëve. Vecanërisht e dobishme asistencë e RISI Albania këshillues të karrierës në UT ku janë bërë pjesë e një kursi trajnimi për zhvillimin e shërbimit efektiv të karrierës. (Evidenca V.20)
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Studentët ALUMNI janë ndjekur në vazhdimësi nga DATK për progresin e tyre në profesion dhe karrierë edhe pas diplomimit. Nga të dhënat e dokumentuara, por edhe nga vizita e GVJ me grup studentësh në institucion e kishin zgjedhur këtë program studimi pasi kishin shembullin e të njohurve të tyre që janë punësuar menjëherë pas përfundimi të studimeve në institucione të rëndësishme. (Evidenca I.60 dhe Evidenca I.22)
Konkluzione	Të gjitha zyrat ofrojnë shërbime mbështetëse dhe informative për studentët në aspektet mësimore në UT. Këto shërbime




	përfshijnë orientimin e aplikantëve, informacionin mbi programet dhe kurrikulat e studimeve, këshillimin për diplomimin dhe mundësitë e studimeve të larta, si dhe asistencën për punësim në sektorin publik dhe privat. Bashkëpunimi i ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore, si dhe përdorimi i rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të universitetit, shërbejnë për të siguruar një përkrahje të efektshme për zhvillimin e studentëve në aspektin mësimor. Zyra e Alumni, ndjek studentët pas diplomimit, ofron informacion dhe këshilla për çështjet mësimore, programet e studimeve dhe diplomimin, ndihmon studentët për vazhdimin e studimeve apo punësimin, dhe mbledh të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të diplomuarve të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UT ofron udhëzues, manuale dhe trajnime institucionale për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. Kjo përfshihet në udhëzuesin institucional. Bazuar në rregulloren e studimeve Bachelor, UT përdor metoda didaktike inovative dhe teknologji në mësimdhënie. Nëpërmjet Paketës së Instrumentave të Cilësisë të aprovuar nga Senati Akademik, FHF realizon pyetësorë studentëve lidhur me procesin e mësimin dhe vlerësimin e pedagogëve. (Evidenca III.5, III.8, III.9)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe	Ashtu sic parashtrohet edhe në RVB ku procesi i Vlerësimit të Brendshëm është ngritur dhe funksionon mbi bazën e një rregulloreje që sqaron rolin dhe përgjegjësitë e strukturave, të organeve dhe autoriteteve drejtuese akademike dhe administrative të krijuara posaçërisht për sigurimin e cilësisë në UT, nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit është konstatuar

Leorez

[Signature]

inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	një funksionim i të gjithë mekanizmave të duhura. GVJ vlerëson si arritje për institucionin një mekanizëm të tillë. <i>(Evidenca III.6)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	UT, sipas Statutit, përfshin studentët në vlerësimin periodik të mësimdhënies dhe dijes. Studentët monitorojnë përgatitjen e tyre dhe ndikojnë në cilësinë e shërbimeve. Instrumenti kryesor në këtë drejtim janë pyetësorët e vlerësimit të modulit të studentëve, një pjesë e mirë e përmbajtjes së të cilëve i referohet procesit të mësimdhënies. Në këto sondazhe studentët japin komentet dhe vlerësimet e tyre mbi aspekte të procesit të mësimdhënies si niveli i përgatitjes dhe njohurive, aftësia dhe metodat e mësimdhënies. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në nivelet institucionale dhe bazë. <i>(Evidenca VI.4).</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, u referohet kriterëve dhe objektivave të përcaktuara periodikisht nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së institucionit (NJSBC). Ndërmarrja e Sondazhit Kombëtar të Studentëve për institucionet (SKS) <i>(Evidenca VI.8)</i> bazohet në opinionin individual të studentëve për institucionet dhe në përfundim të tij hartohet raporti analitik me rezultatet e pyetësorëve, shoqëruar me analizat përkatëse si dhe analiza krahasuese për indikatorë të ndryshëm përkundrejt interesit publik. Raporti dhe rezultatet bëhen publike.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UT inkurajon praktikatat e mira në mësimdhënie duke përdorur mekanizmat e vlerësimit dhe rezultateve të marra. Rezultatet e marra nga përpunimi i pyetësorëve i janë dokumentuar, analizuar dhe zgjidhur brenda Njesisë Bazë. <i>(Evidenca III.9)</i>
Konkluzione	<i>UT shfaq një qasje progresive dhe angazhim të vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes inovacionit dhe përdorimit të teknologjisë. Me udhëzues, manuale dhe trajnime institucionale, institucioni promovon praktika të mira në mësimdhënie. Përballë sfidave të pandemisë Covid-19, UT siguroi një tranzicion të suksesshëm në mësimin online duke ofruar udhëzime dhe resurse të nevojshme teknologjike për përdorimin e platformave, siç dëshmojnë evidencat specifike. Kjo tregon një angazhim të vazhdueshëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, përfshirë përdorimin e mekanizmave të vlerësimit dhe analizave të rezultateve. Gjithashtu, UT ndjek një qasje të strukturuar dhe transparente për cilësinë nëpërmjet</i>




	Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe ka synim për një përjasje të vëmendshme ndaj sugjerimeve dhe propozimeve për ngritjen e cilësisë në të gjitha nivelet e institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UT, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Neni 103, ka hartuar politika dhe themeluar struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila ka në përbërje përfaqësues të njësive bazë dhe dy studentë. <i>Nenet 6 dhe 7 të rregullores së kësaj njësie sqarojnë funksionet lidhur me procesin e vetëvlerësimit dhe mbikqyrjes së procesit të mësimit. (Evidenca II.4)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Standardit të Cilësisë (KPSSC) koordinojnë punën në funksion të sigurimit të cilësisë në institucion. Po ashtu edhe Paketa e Sigurimit të Cilësisë përmes pyetësorëve të studentëve i vjen në ndihmë përmbushjes së cilësisë. <i>(Evidenca III.5)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë	Sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë është pjesë e strategjisë institucionale si dhe planeve të veprimit në nivel institucional. Në kuadrin e vlerësimit të cilësisë, UT ka zbatuar procedurat e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit në përputhje me rregullimet ligjore. Universiteti ka respektuar detyrimet ligjore që lidhen me aplikimin për akreditimin institucional pranë ASCAL. Institucioni ka kryer akreditimin institucional në vitin 2023, në bazë të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 04, datë, 27.01.2023, ku ka marrë vlerësim maksimal. Përmes Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Standardit të Cilësisë (KPSSC) në UT dhe Rregullores përkatëse parashtrohet e gjithë korniza e sigurimit të cilësisë së studimit

Leolueq'

[Signature]

cilësinë në programin e studimit.	dhe mësimdhënies. (Evidenca III.6)			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Studentët përmes pyetësorëve kanë mundësinë të shprehen për mbarrëvajtjen e programit të studimit, burimet e të nxënit, cilësinë e mësimdhënies, kontrollin e njohurive, metodologjinë e pedagogut të lëndës dhe ndjekjen e studentëve me detyrat e kursit dhe gjithë detyrimet e lëndëve. Pyetësori zhvillohet në kushtet e anonimatit të plotë dhe pa praninë e stafit akademik. Edhe nga vizita e GVJ dhe biseda me studentët, ato u shprehën që në asnjë rast nuk janë ndier të trysnuar lidhur me vlerësimet e tyre apo sugjerimet për përmirësime në të ardhmen. (Evidenca III.8)			
Konkluzione	UT, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 ka vendosur politika dhe struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. NJSBC dhe KPSSC duke përfshirë studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, ndjekin një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Bashkëpunimi me institucione të tjera kontribuon në shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e bashkëpunimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për	UT implementon mekanizma dhe procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit të ciklit të parë. Në nivel institucional, UT zhvillon çdo vit Raportin Vjetor, bazuar në Raportet Vjetore të Departamenteve dhe Fakulteteve. Njësitë bazë dorëzojnë raportet vjetore të veprimtarisë, aktiviteteve të brendshme dhe gjithashtu tërësinë e angazhimeve të personelit akademik kryesisht në botime, pjesëmarrje konferencash, marrëveshje bashkëpunimi, projekte kërkimore shkencore dhe mobilitete. (Evidenca III.III, III.12, III.13, III.42, III.43, I.28, I.3, I.30)

Leopold
Leopold 

përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfaqësojnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Referuar RVB por edhe dokumentacionit të ofruar raportet e vlerësimit ndiqen nga grupi i NJSBC me anëtarë të fakultetit nga cdo njësi bazë duke u përpiluar nga GVB i cili kontrollon me detaje procesin e organizimit të dokumentacionit brenda cdo njësie bazë dhe gjithë përmbajtjes së raportit të vlerësimit sipas formatit të kërkuar. <i>(Evidenca I.5, I.7, II.4)</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Përveç pyetësorëve të cilët mbeten burimi kryesor i dhënave për procesin e vlerësimit të brendshëm, DATK ka anagzhuar stafin akademik në rastet kur studentët kanë adresuar problematika. Angazhimi maksimal i Përgjegjësit të DATK bashkë me koordinatorin e programit të ciklit të parë të studimeve monitorojnë nga afër procesin e mësimdhënies dhe cdo problematikë të studentëve lidhur me rezultatet e lëndëve sipas afateve kohore etj. <i>(Evidenca I.37)</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e	Njësia bazë përdor pyetësorë, teste dhe sondazhe për vlerësim, duke synuar matjen e performancës së stafit akademik dhe cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit. Këto metoda

cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	sigurojnë një analizë të detajuar të performancës së programit në përputhje me nevojat e studentëve dhe standardet e përcaktuara. Kontakti i vazhdueshëm me studentët ALUMNI për përfshirjen e tyre në tregun e punës në profilet e studimit të Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore janë shumë të kënaqshme. (Evidenca V.13 dhe I.22) Studentët ALUMNI përfshihen në mbikqyrjen e praktikave mësimore, asistimin në seminarët e lëndëve apo dhe intership në institucione publike. (Evidenca VI.10)			
Konkluzione	UT ka procese formale për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, duke i dokumentuar ato në Raportin Vjetor. Raportet janë të detajuara duke përfshirë strategji efektive për përmbushjen sa më mirë të standarteve të cilësisë së mësimdhënies. Ruajtja e marrëdhënieve me studentët ALUMNI dhe mundësia e angazhimit të tyre në institucion me veprimtari të ndryshme, siguron një qëndrueshmëri të programit të studimit në tregun e punës. Nga vizita e GVJ në institucion, prezëntë kishte edhe studentë ALUMNI të cilët punonin në institucione të rëndësishme shtetërore si specialistë të trashëgimisë kulturore, arkeologë, ekspert restautor etj. Dhe që ishin angazhuar në DATK për mbulimin e orëve të praktikave për studentët aktualë apo realizimin e seminareve sipas profilit të tyre. Kjo mënyrë e angazhimit të tyre siguron jetëgjatësi të programit të studimit, pasi të rinjtë gjejnë mundësi të punësohen më shpejt.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Llosoes

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	DATK zbaton politika dhe procedura të brendshme të cilësisë për programet e studimit. Ajo angazhohet në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit, duke përfshirë aktorë të jashtëm të interesuar. Bashkëpunimi me institucione analoge, veçanërisht jashtë vendit, shprehet në bashkërendimin e përpjekjeve për zhvillimin e një programi të përbashkët. Gjithashtu, për përmirësimin e përmbajtjes së programit dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës, zyra e Alumni janë pjesëmarrës dhe promovojnë programet në evente të ndryshme, duke marrë parasysh propozimet dhe eksperiencat e maturantëve dhe studentëve.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni promovon rolin e individëve dhe studentëve për sigurimin e cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë rol kyç në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, të përfaqësuar me një grup të tërë pune. Këto struktura bashkë me Grupet e Vlerësimit të Brendshëm janë përgjegjëse për të ndjekur procesin e sigurimit të cilësisë institucionale. <i>(Evidenca III.5, II.4, I.7, I.6)</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Institucioni thekson rëndësinë e rolit të individëve dhe studentëve në sigurimin e cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidenca II.4)</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja e të gjithë aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit të cilësisë mundësohet në përputhje me parimet e integritetit akademik, barazisë dhe ndalimit të diskriminimit. Në Njësinë Bazë të DATK, në UT, nuk janë evidentuar dukuri negative në lidhje me cilësinë e procesit mësimor dhe fushën akademike. Përpjekjet janë bërë për të trajtuar edhe dobësitë në mënyrë të kujdesshme dhe jo të drejtpërdrejtë. Aktet normative të brendshme janë taksative dhe rigorozë, duke përfshirë Kodin e Etikës dhe rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, duke u mbështetur në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. (Ligji 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri...)

	DATK ka vëmendje të vecantë sidomos ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë sonë, kryesisht apo minoritare, gjendjes ekonomike apo edhe diversitetit fetar, seksual apo studentëve me aftësi ndryshe. (Evidenca I.17 dhe III.15)			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	UT dhe FHF mbeten aktive në organizimet e aktiviteteve që përfshijnë bashkëpunëtorë dhe ekspertë të huaj. Nga të dhënat e RVB janë evidentuar shumë marrëveshje me institucione të tjera, por edhe nga vizita në institucion e GVJ Fakulteti në tërësi, por specifikisht Dekanati mundësonte çfarëdo lloj bashkëpunimi rezultativ. Vetë Njësia Bazë siguronte një mori marrëveshjesh dhe bashkëpunimesh si brenda dhe jashtë vendit, kjo falë edhe stafit shumë të kualifikuar të cilët kanë kryer studime universitare apo pas universitare në SHBA dhe Evropën Perëndimore. (Evidenca III.15, VI.11, VI.12, VI.13, VI.14, I.60)			
Konkluzione	Nëpërmjet politikave të tij të sigurimit të cilësisë, UT mundëson angazhimin e një sërë aktorësh në procesin e vlerësimit të cilësisë si dhe aksesimin e kontributeve të gjithsecilit në këtë proces. Njësia Bazë ka politika të brendshme për cilësi, përfshirë aktorë të jashtëm dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Institucioni vlerëson rolin e individëve dhe studentëve për cilësi, ndërsa Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë rol kyç.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UT përcakton një parim kryesor në drejtim të transparencës dhe publikon informacionin lidhur me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë nëpërmjet faqes zyrtare dhe programit të transparencës. Në këtë drejtim, përfshihen mekanizmat kontrollues, planet strategjike, raportet vjetore të veprimtarive akademike dhe monitorimit të cilësisë së programeve të studimit. Njësia Bazë ndjek këtë praktikë duke përdorur mjetet e veta të komunikimit në faqen e internetit dhe në faqen e Facebook të departamentit.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon	UT, në përputhje me parimet e lirisë dhe etikës akademike, si dhe në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale,



rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	respekton këto vlera në publikimin e rezultateve dhe vlerësimeve të programeve të studimit. Raportet publikohen në respekt të anonimitetit dhe të përgjithësuara në fokus të rezultateve të analizavë të pyetësorëve. (Evidenca III.18, VI.15.I.3)			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raportet e vlerësimit i trajtojnë pikat e forta dhe të dobëta, duke hartuar detyra dhe afate për përmirësim. DATK ka realizuar mbledhje dhe diskutime në marrjen e masave për ndryshime të mundshme që do kanë reflektuar përmirësimin e programit të studimit, rritjen e kapaciteteve të laboratorit apo dhe rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në projekte bashkëpunuese me institucione të tjera. (Evidenca II.4. I.3, III.16)			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UT përdori me efektivitet këto procese me një qëllim thelbësor: përmirësimin vazhdueshëm të cilësisë me përfshirje të stafit akademik, ndihmës-akademik dhe studentë. (Evidenca I.8, VI.8)			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore zbaton veprimtari periodike, përfshirë sondazhe, anketime, dhe plotësimin e formularëve të kontrollit. Këto aktivitete janë pjesë e një strategjie afatgjatë për sigurimin e cilësisë në programet e studimit dhe zhvillimin e tyre. Përmes fushatave informuese, personeli akademik dhe studentët janë të ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e përmirësimit të cilësisë dhe janë inkurajuar të marrin pjesë aktivisht. (Evidenca VI.16, VI.17)			
Konkluzione	UT me transparencë të plotë publikon sondazhet e studentëve në faqen zyrtare https://www.fhf.edu.al/studentet/ Ndjekin strategji të mirëmenduara me fokus përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies apo problematikave të tjera të gjetura nga sondazhet. Ka një bashkëpunim institucional shumë të mirë, duke bashkërenduar punën e departamentit me strukturat e tjera përgjegjëse në funksion të përmbushjes së standarteve. Edhe problemin e shfaqur gjatë pandemisë COVID-19, është gjendur një alternativë zgjidhjeje duke publikuar cdo të dhënë në shtypin e shkruar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në:
“Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti Histori Filologji, me histori të njohur në Republikën e Shqipërisë përse i përket formimit shkencor të studentëve;
2. Institucioni operon në një zonë me diversitet të shumtë socio-kulturor, etnik e gjuësor dhe departamenti që organizon programin e studimit tregon një nivel të lartë ndjeshmërie në gjithëpërfshirje, çka demonstron edhe nga target-grupi i studentëve në programin e studimit në vite, por edhe nga statistikat e të punësuarve në shumë sektorë në vendin tonë;
3. Departamenti ka dëshmuar interes dhe përpjekje të përqendruara për të shtuar burimet e tij njerëzore akademike, me staf të kualifikuar dhe ekspertizë të vecantë që i përgjigjet programit të studimit;
4. Programi i studimit ofron një qasje ndërdisiplinore, duke i mundësuar studentëve të kultivojnë njohuri teorike dhe të mund të marrin aftësi në aplikimet metodologjike më të fundit të tërësisë së fushave të ekspertizës në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë;
5. Stafi akademik me kualifikim tejet cilësor ka si filozofi të mësimdhënies strategjinë e të menduarit kritik gjatë procesit mësimor, me qëllim që studentët të jenë pjesë e procesit me idetë e tyre të pavarura, të punojnë në terren apo laboratorë etj;
6. Literatura e përdorur është bashkëkohore, vjen kryesisht në gjuhë të huaja (anglisht, frengjisht) ku studentët kanë mundësi të njihen me arritjet ndërkombëtare në arkeologji dhe trashëgimi kulturorë;
7. Studentët e këtij programi, nëpërmjet lëndëve të ndryshme marrin njohuri akademike, të cilat janë të mjaftueshme për të dalë në tregun e punës;
8. Pajisja me Laboratorë të fundit, angazhimi i një stafi mjaft të kualifikuar të cilët sjellin përvojën më të mirë, iu siguron studentëve një formim cilësor dhe bashkëkohor;

b. Pika për përmirësim:

1. GVJ konstaton një devijim të vogël (2 %) tek veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë”, me ngarkesën respektive në kredite të përcaktuar sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, e cila nuk përbën problem në realizimin dhe arritjen e objektivave të programit të studimit; (*Standarti III.4, kriteri 1*)

Rekomandime

1. GVJ rekomandon, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite me qëllim që të përputhet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018;
2. GVJ rekomandon që në kuadrin e strategjisë për gjithë përfshirjen, të zhvillohet, buxhetohet dhe implementohet një plan për pajisjen e bibliotekës me teknologji asistuese, duke përfshirë aksesorë dhe pajisje të tjera që mund të përmirësojnë përvojën e studentëve me paafësi ose afësi të kufizuara;

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Archaeology and Cultural Heritage"

a. Strengths and affirmations:

1. The study program is offered by the Faculty of History and Philology, with a well-known history in the Republic of Albania in terms of the scientific education of students;
2. The institution operates in an area with great socio-cultural, ethnic and linguistic diversity and the department that organizes the study program shows a high level of sensitivity to inclusiveness, which is demonstrated both by the target group of students in the study program over the years, but also by the statistics of employees in many sectors in our country;
3. The Department has demonstrated interest and focused efforts to increase its academic human resources, with qualified staff and specific expertise that responds to the study program;
4. The study program offers an interdisciplinary approach, enabling students to cultivate theoretical knowledge and acquire skills in the latest methodological applications of the full range of fields of expertise in Archaeology and Cultural Heritage;
5. The highly qualified academic staff has as its teaching philosophy the strategy of critical thinking during the learning process, with the aim of students being part of the process with their independent ideas, working in the field or laboratories, etc;
6. The literature used is contemporary, mainly in foreign languages (English, French) where students have the opportunity to become familiar with international achievements in archaeology and cultural heritage;
7. Students of this program, through various subjects, obtain academic knowledge, which is sufficient to enter the labor market;
8. Equipped with state-of-the-art laboratories, the engagement of highly qualified staff who bring the best experience, provides students with a quality and contemporary education;



8. Equipped with state-of-the-art laboratories, the engagement of highly qualified staff who bring the best experience, provides students with a quality and contemporary education;

b. Points for improvement:

1. The EEG finds a small deviation (2%) in the formative activities of the Bachelor's study program in "Archaeology and Cultural Heritage", with the respective load in credits determined according to the Decision of Council of Ministers No. 41, dated 24.01.2018, which does not constitute a problem in the realization and achievement of the objectives of the study program; (*Standard III.4, criterion 1*)

Recommendations

2. The EEG (External Evaluation Group) recommends that the distribution of the respective load on credits be reviewed in order to comply with the provisions of the Council of Ministers No. 41, dated 24.01.2018;
3. The EEG (External Evaluation Group) recommends that, within the framework of the strategy for all inclusion, a plan should be developed, budgeted and implemented to equip the library with assistive technology, including accessories and other devices that can improve the experience of students with disabilities or limited abilities;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X